

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5546  
E mërkurë, 8 gusht 2018  
çmimi 0.40 €

## Thaçi: Korrigjimi i kufijve, mundësia e vetme që Lugina t'i bashkohet Kosovës

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

#### SHKËMBIMI I TERRITOREVE

F. 11

Rexhep QOSJA



#### MBI 200 TË MITUR TË ARRESTUAR PËR PËRDORIM TË DROGAVE

F. 10

#### SUSPENDOHEN TRE MJEKË TË OKUK-SË, NUK ISHIN NË VENDIN E PUNËS

F. 10

### EKONOMI

#### HASANI E BEQAJ I OFROJNË PËRKRAHJE OEK-ut

F. 9

#### KADAJ-BUJUPI: DUHET KUJDES I SHTUAR NË POLITIKAT SOCIALE

F. 9

### KULTURË

#### TEATROT E QYTETEVE TË KOSOVËS DO TË BËHEN ME LIGJ TË RI

F. 14

### SPORT

#### FETAHAJ: E ARDHMJA IME VENDOSËT BRENDA JAVËS

F. 18

#### BEHRAMI: VENDIM POLITIK, I ZHGËNJYER QË MA THANË ME NJË TELEFONATË

F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", BLERIM KUÇI

FAQE 4-5

## Kryeministri do të ketë rol në bisedimet me Serbinë



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Blërim Kuçi, ka bërë me dije se kryeministri Ramush Haradinaj do të ketë rol në bisedimet me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kreu i ekzekutivit së shpejti do t'i takojë

liderët e subjekteve parlamentare për të diskutuar për platformën e bisedimeve për fazën finale të dialogut me Serbinë, ku pastaj kjo platformë do të miratohet në Kuvendin e Kosovës. Sipas Kuçit, procesi i dialogut me Serbinë duhet të jetë jashtë kornizave dhe garës pozitive

dhe opozitë. Ai ka thënë se në raport me këtë proces të gjithë duhet të jenë unikë. Duke folur për kërkesën e opozitës për zgjedhje të reja, Kuçi ka theksuar se kërkesa e opozitës për zgjedhje të reja është e zbrazët karshi kërkesave që ka tani Kosova

## Qeveria kërkon më shumë punë për zbatimin e MSA-së



Institucionet e Republikës së Kosovës kanë treguar performancë më të dobët në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Acocimit (MSA) në gjashtëmujorin e parë të këtij viti krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kështu ka deklaruar ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, në mbledhjen e së martës të kabi-

netit qeveritar. Ajo ka kërkuar angazhim më të madh nga të gjitha institucionet në këtë proces në mënyrë që të ketë zbatim më të lartë dhe më të mirë të MSA-së. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar nga vartësit e tij të jenë më seriozë dhe më të fokusuar në procesin e zbatimit të MSA-së

FAQE 3



## Lëvizja Vetëvendosje kërkon zgjedhje të reja

Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci, kanë mbajtur të martën konferencë për medie, në të cilën kanë folur për zhvillimet e fundit politike në vend. Deputetja Nagavci ka thënë se është e domosdoshme që vendi të shkojë në zgjedhje dhe të krijohet qeveri e re

FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjbiznesi.com  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Nishani: Propozimi i Thaçit nxit konfliktet

TIRANË, 7 GUSHT - Ish-presidenti shqiptar Bujar Nishani ka folur për zhvillimet më të fundit që lidhen me Kosovën, vendimin e NATO-s për ta kthyer në një bazë të sajën ish-aeroportin ushtarak të Kuçovës, procesin e vettingut si dhe për zhvillimet më të fundit në gjirin e opozitës dhe se si është duke qeverisur Edi Rama. Ish-presidenti Nishani e shikon propozimin e presidentit Hashim Thaçi për shkëmbime terriroresh si një propozim të kahershëm serb dhe të rrezikshëm për të gjithë rajonin. "Destabilitet,

pasiguri dhe nxitje të konfliktit", kështu e shikon Bujar Nishani propozimin e Hashim Thaçit. Nishani thekson se "Çdo tendencë apo tentativë për të krijuar një model të rivendikimit të terrirore dhe kufijve të njohur ndërkombëtarisht pas shpërbërje të ish-Jugosllavisë midis Kosovës dhe Serbisë, padyshim kthehet në një problem përplasjes rajonale". Vendimin e NATO-s për ta kthyer e një bazë të sajën ish-aeroportin e Kuçovës, Bujar Nishani e shikon ngushtësisht të lidhur me sta-

bilitetin e Ballkanit po ashtu edhe si një përgjigje për super bazën ushtarake që ka ndërtuar Serbia në Nish.

Për procesin e deritanishëm të vettingut, Bujar Nishani shprehet se është duke u zhvilluar me standarde të dyfishta dhe se kriza ku është futur Gjykata Kushtetuese dhe ajo e Lartë ka të bëjë me nxitimin e politikës shqiptare dhe të ndërkombëtarëve për të pasur me doemos një reformë në drejtësi.

Pas traumave politike që ka pasur opozita Bujar Nishani është i



mendimit se PD-ja ka pasur një ngjitje për sa i përket komunikimit me publikun dhe një ridimensionim të rolit të saj por sipas tij, duhet një prezencë e përditshme dhe fuqizim i bazës së partisë.

Bujar Nishani parashikon se do të kemi një sezon të ri politik të tensionuar në shtator pasi opozitës po i mbyllet hapësirat po ashtu edhe si pasojë e kapjes së sistemit të drejtësisë.

## NATO-ja tregon qëllimin e bazës ajrore në Shqipëri

Zëdhënësi Piers Cazalet tha se Programi i Investimit të Sigurisë së NATO-s mbulon projekte kryesore ndërtuese në vendet aleate me qëllim përmirësimin e sigurisë në hapësirën e NATO-s. "Ky program është pjesë e financimit të përbashkët të NATO-s në të cilin kontribuojnë të 29 vendet anëtare", tha zyrtari i NATO-s



TIRANË, 7 GUSHT - Zëdhënësi i NATO-s, Piers Cazalet, thotë se financimi i bazës ajrore në Kuçovë është pjesë e Programit të Investimit të Sigurisë. Investimi, sipas tij, kap vlerën e 51 milionë eurove. "NATO ka në plan të investojë 51 milionë euro për ta modernizuar bazën ajrore të Kuçovës në Shqipëri. Paratë do të shkojnë drejt përmirësimit të infrastrukturës në bazë, përfshirë edhe depot e karburantit", konfirmoi Cazalet.

Duke folur për ATSH, ai thotë se Programi i Investimit të Sigurisë së NATO-s mbulon projekte kryesore ndërtuese në vendet aleate me qëllim përmirësimin e sigurisë në hapësirën e NATO-s. "Ky pro-

gram është pjesë e financimit të përbashkët të NATO-s në të cilin kontribuojnë të 29 vendet anëtare", tha zyrtari i NATO-s. Aleanca, thotë Cazalet, i është mirënjohëse Shqipërisë për kontributin në NATO. "Ne jemi mirënjohës për kontributin e çmuar të Shqipërisë për sigurinë tonë të përbashkët, përfshirë misionet tona në Afganistan dhe Kosovë. Shqipëria gjithashtu u jep një mbështetje të fortë partnerëve tanë, përfshirë kontributin në fondet tona të kujdestarisë për Ukrainën, ndihmën në mbrojtjen kibernetike dhe transicionin e karrierës ushtarake", deklaroi ai. Shqipëria, theksoi Cazalet, luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në luftën kundër ISIS-it,

duke kontribuar me pajisje dhe trajnime për Irakun. "Shqipëria gjithashtu na ndihmon të rrisim sigurinë duke promovuar bashkëpunimin në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Vendi juaj është një avokat i fortë i politikës së dyerve të hapura të NATO-s dhe i integritetit të fqin-

jëve tuaj në familjen euroatlantike", tha zëdhënësi i NATO-s, Piers Cazalet. Përmes këtij projekti, i cili pritet të nisë brenda këtij viti, Kuçova do të shërbejë si bazë mbështetëse për NATO-n për furnizim ajror; mbështetje logjistike; mbështetje për

policimin ajror; si dhe trajnime dhe stërvitje të Aleancës. Kuçova do të shërbejë gjithashtu edhe si bazë kombëtare për Forcën Ajrore shqiptare dhe investimi i NATO-s në Shqipëri do të sjellë një standard të ri për Forcat e Armatosura dhe investime për zonën e Kuçovës.

## Vuçiqi: As serbët e as shqiptarët nuk do të festojnë për marrëveshjen

BEograd, 7 GUSHT - President i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha se tash është koha më e mirë për të gjetur një zgjidhje me Kosovën dhe se vendi i tij është i interesuar për paqe dhe jo të ketë vrasje për territor. "Zgjidhja e problemit të Kosovës duhet të bëhet sa më shpejt, si dhe serbët e shqiptarët duhet të deklarohen a kemi nevojë për paqe apo të vazhdojmë të vritemi për territor?", tha presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, në një konferencë me gazetarë në Beograd.



Vuçiqi u shpreh se marrëveshja, për të cilën ai ka dyshime se do të arrihet, nuk do t'i bëjë serbët të festojnë, por as shqiptarët nuk do

të festojnë. "Ne kemi nevojë për paqe të qëndrueshme ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve, zgjidhje kjo, që do të krijonte njëfarë sig-

urie për qytetarët tanë", deklaroi Vuçiqi. "A mundet Serbia të marrë më shumë sesa që ka sot? Pozicioni im si president është i qartë: zgjidhja e problemit është e domosdoshme, sa më parë. Ne kemi nevojë për paqe të qëndrueshme në mes të serbëve dhe shqiptarëve, është e rëndësishme që të krijojmë siguri për qytetarët tanë, sa më parë. Por, është e rëndësishme gjithashtu që kur të arrijmë një paqe të tillë, t'i kushtojmë vetes rëndësi në zhvillimin ekonomik dhe të mos lejojmë

faktorë të tjerë të dalin në rrugën tonë", tha presidenti serb. Vuçiqi gjithashtu tha se serbët nga Kosova nuk do të jenë të vetëm në formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Do të punoj nga afër për të përcjell dhe monitoruar zhvillimet në bashkësinë ndërkombëtare dhe do të insistoj për të drejtat tona", tha Vuçiqi, duke theksuar se kanë kaluar 1930 ditë nga dita kur ishte dashur të formohej Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.



Është mbajtur mbledhja e radhës e Qeverisë së Republikës së Kosovës

# Qeveria kërkon më shumë punë për zbatimin e MSA-së



Institucionet e Republikës së Kosovës kanë treguar performancë më të dobët në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Acocimit (MSA) në gjashtëmujorin e parë të këtij viti krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kështu ka deklaruar ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, në mbledhjen e së martës të kabinetit qeveritar. Ajo ka kërkuar angazhim më të madh nga të gjitha institucionet në këtë proces në mënyrë që të ketë zbatim më të lartë dhe më të mirë të MSA-së. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar nga vartësit e tij të jenë më seriozë dhe më të fokusuar në procesin e zbatimit të MSA-së

tremujorit të dytë janë zbatuar gjithsejtë 68 masa, të cilat përbëjnë 12.78 për qind të të gjitha masave të planifikuara. Kjo tregon performancë më të dobët të institucioneve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017 pasi që gjatë asaj periudhe kemi arritur të zbatonim 32.02 për qind të masave të planifikuara", është shprehur Hoxha, duke kërkuar nga institucionet përkatëse më shumë angazhim për procesin e zbatimit të MSA-së. "Kemi diskutuar me kryeministrin dhe shumë shpejt do të mbajmë edhe një takim të këshillit ministror për ta shtuar agjendën e zbatimit të MSA-së në mënyrë që të arrijmë një zbatim sa më të mirë dhe më të lartë. Duhet bërë reforma që kërkojnë vëmendje në pjesën e mbetur të vitit si miratimin e ligjeve, miratimin e politikave dhe strategjive, reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve, sipas sektorëve dhe institucioneve

## Rifat Jashari shpallet qytetar me merita të veçanta

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së martës ka marrë vendim që vëllait të komandantit legjendar Adem Jashari, Rifat Jasharit, t'i njihet statusi i qytetarit me merita të veçanta për konsolidimin e shtetit të Kosovës. Sipas këtij vendimi, Rifat Jashari do t'i gëzojë të gjitha përfitimet e rregulluara me këtë vendim. Po ashtu, në

këtë mbledhje është bërë edhe plotësim-ndryshimi i vendimit të Qeverisë së 29 prillit të vitit 2008 me të cilën është rregulluar kompensimi dhe trajtimi institucional për Adem Demaçin. Me plotësimin dhe ndryshimin e vendimit është rregulluar që pas vdekjes së Adem Demaçit përfitimet e tij t'i gëzojë bashkëshortja.

**EPOKA  
ERE**

Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 7 GUSHT** - Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, të martën e ka informuar kabinetin qeveritar me të gjeturat e zbatimit të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Acocimit (MSA) gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti. Me këtë rast ajo ka bërë me dije se të gjeturat tregojnë performancë më të dobët të institucioneve në zbatimin e MSA-së krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Në këtë kontekst, Hoxha ka theksuar se programi për këtë vit përmban 532 masa afatshkurtra, prej të cilave 144 ose rreth 27 për qind janë masa legjislative, ndërsa 388 masa ose rreth 73 për qind prej tyre janë masa zbatuese. "Bazuar në të gjeturat e këtij raporti, gjatë

tremujorit të dytë është arritur një shkallë e përgjithshme e zbatimit të programit prej 24.33 përqindësh, pasi që 18 nga 74 masat e planifikuara për këtë tremujor janë zbatuar, ndërsa pjesa e mbetur prej 56 masave, ose 76.67 për qind, akoma nuk ka arritur të zbatohet. Përveç këtyre, 27 masa janë zbatuar para afateve të planifikuara, e kjo i bie që deri në fund të

## Qeveria mbështet Kooperativën "Krusha" dhe festivalin "Dokufest"

Po në mbledhjen e së martës Qeveria ka ndarë 20 mijë euro për Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër "Dokufest". Gjithashtu, kabineti qeveritar ka ndarë 23 920 euro për Kooperativën Bujqësore "Krusha". Kjo kooperativë është trashëguese e shoqatës "Grat e veja" që përbëhej nga gratë kryefamiljare të fshatit Krushë e Komunës së Rahovecit. Kooperativa merret me kultivimin e perimeve dhe përpunimin e tyre.

përgjegjëse. Prandaj kërkoj nga të gjitha institucionet që të rrisin zbatimin e MSA-së", ka deklaruar Hoxha. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar nga vartësit e tij të jenë më seriozë dhe më të fokusuar në procesin e zbatimit të MSA-së. "Secila ministri, por edhe zyra e kryeministrit, duhet të angazhohen për zbatimin e masave të paraparë të MSA-së. Në takimin e ardhshëm ndërministror që do ta mbajmë së shpejti do të bëjmë edhe një evidencë apo do t'i shohim të gjeturat e fundit në mënyrë që të jemi më seriozë dhe më të fokusuar në zbatimin e MSA-së. Prandaj duhet ta marrim të gjithë seriozisht zbatimin e MSA-së", ka thënë Haradinaj. Në këtë mbledhje të Qeverisë është aprovuar Projektligji për ratifikimin e ndryshimit dhe

plotësimin të marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Po ashtu, kabineti qeveritar ka miratuar programin legjislativ për vitin 2018, me ç'rast është thënë se në këtë periudhë të mandatit qeverisës është dëshmuar një dinamikë e punës me 675 vendime të aprovuara, 81 projektligji, 33 akte nënligjore, 24 koncept dokumente, 8 strategji dhe 97 akte nënligjore të ministrive. Qeveria ka miratuar edhe planin e veprimit për zbatimin e Strategjisë për modernizimin e administratës publike 2018-2020. Ky plan përqendrohet në arritjen e rezultateve në fushën e shërbimit civil, në shërbimet publike administrative dhe procedurat administrative, si dhe në llogaridhënie dhe organizimit të administratës shtetërore.

## Haradinaj: Kufijtë e Kosovës lëvizin vetëm me luftë

**PRISHTINË, 7 GUSHT** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se lëvizja e kufijve të Kosovës mund të bëhet vetëm me luftë dhe, sipas tij, çështja e vetme që mund të diskutohet me Serbinë është njohja reciproke. "Kufijtë janë vendosur me luftë, veç lufta i luan. Kush kujton se luhen kufijtë ndryshe, gabon", ka

thënë Haradinaj në një konferencë për media pas mbledhjes së Qeverisë. Ai ka shtuar se këta kufij janë vendosur nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe ndërhyrja e NATO-s. "Këta janë kufij lufte", është shprehur Haradinaj. Sipas tij, krejt çfarë ka mbetur të diskutohet me Serbinë është vetëm njohja reciproke për të cilën ai thotë

se e mbështet presidentin Hashim Thaçi. "Kufijtë me lëviz i interesojnë vetëm Vladimir Putinin. Në kontinentin tonë, nuk ka tjetër kujt që i intereson. Ne nuk i takojmë hartës së tij. Ne i takojmë nja bote tjetër që e udhëheqë Amerika e ne nuk u përshtatemi lojërave të tij, nuk i luajmë kufijtë", ka thënë Haradinaj.





Flet për "Epokën e re", Blerim Kuçi

# Kryeministri do të ketë rol

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Blerim Kuçi, ka bërë me dije se kryeministri Ramush Haradinaj do të ketë rol në bisedimet me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kreu i ekzekutivit së shpejti do t'i takojë liderët e subjekteve parlamentare për të diskutuar për platformën e bisedimeve për fazën finale të dialogut me Serbinë, ku pastaj kjo platformë do të miratohet në Kuvendin e Kosovës. Sipas Kuçit, procesi i dialogut me Serbinë duhet të jetë jashtë kornizave dhe garës pozitive dhe opozitive. Ai ka thënë se në raport me këtë proces të gjithë duhet të jenë unikë. Duke folur për kërkesën e opozitës për zgjedhje të reja, Kuçi ka theksuar se kërkesa e opozitës për zgjedhje të reja është e zbrazët karshi kërkesave që ka tani Kosova

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 7 GUSHT** - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Blerim Kuçi, ka paralajmëruar se kryeministri i vendit do të ketë rol kyç në fazën finale të dialogut me Serbinë. Ai ka deklaruar se kreu i ekzekutivit ka komunikim me të gjitha partitë parlamentare dhe shumë shpejt do t'i thërras në një takim për të diskutuar rreth hartimit të platformës për bisedimet me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kuçi ka treguar se platforma do ta përcaktojë edhe formatin e bisedimeve. "Ne e patëm një debat në Kuvend për fazën e fundit të dialogut me Serbinë dhe si konkluzion i këtij debati ishte kërkesa e opozitës që kryeministri ta ketë një rol kyç në këtë epilog të dialogut. Pra, si rekomandim ishte që kryeministri t'i thërras liderët e partive parlamentare dhe ta krijojnë së bashku një platformë të bisedimeve në të cilën do të caktohet edhe formati i personaliteteve që do të shkojnë në këto bisedime. Po

shpresoj që kryeministri do t'i thërras liderët e partive parlamentare dhe të bisedojnë ku pastaj do të dalin me një platformë e cila do të aprovohej në Kuvendin e Kosovës", ka thënë Kuçi. Ai ka vlerësuar se opozita duhet të jetë e përgjegjshme në këtë proces dhe të mos bëjë vetëm deklarata boshë.

Kuçi ka deklaruar se askush nuk duhet t'i ikë këtij procesi. "Mendoj se kryeministri vetëm e ka filluar këtë proces, mirëpo nuk duhet të ketë lojë të partive në këtë proces dialogues. Prosesi i dialogut me Serbinë duhet të jetë jashtë kornizave dhe garës pozitive dhe opozitive. Në raport me këtë proces duhet të jemi të gjithë unikë dhe të ulemi të bisedojmë. Tanimë kryeministri ka një komunikim dhe pritjet vetëm të takohen për hartimin e një platforme për bisedime. Nëse një parti politike i ikën kësaj çështje, atëherë diçka nuk është në rregull me atë parti dhe ajo parti qendrën e saj nuk e ka brenda, por jashtë Kosovës", është shprehur ai, duke shtuar se faza e fundit e dialogut me Serbinë duhet të jetë jashtë garës

së përditshme në mes të partive politike.

Sipas Kuçit, Kosova në këtë fazë duhet të hyjë vetëm si unike. "Epilogu i dialogut me Serbinë duhet të jetë jashtë kësaj garës së zakonshme të brendshme politike. Nëse nuk e kuptojmë këtë atëherë diçka me partitë tona politike nuk është në rregull. Nuk ka kuptim që subjektet tona politike të mos ulen dhe ta krijojnë një platformë për këto bisedime dhe ta caktojnë formatin e bisedimeve se kush do ta përfaqësojë Kosovën në këtë dialog. Ne nuk kemi nevojë ta marrim me vesh këtë fazë, sepse Kosova është shtet i pavarur dhe funksional me kufijtë e vet dhe në këtë fazë ne duhet të hyjmë vetëm kur jemi unikë dhe të përgatitur", ka deklaruar Kuçi.

**"Epoka e re":** Z. Kuçi, presidenti Hashim Thaçi ka propozuar idenë që përmes korigjimit të kufirit me Serbinë të bashkohet Lugina e Preshevës me Kosovën. Cili është qëndrimi i AAK-së për këtë çështje?

**Kuçi:** Ne nuk kemi ndryshuar qëndrim ani pse tani kjo është në

një ambient tjetër, sepse tani jemi në fazën e epilogut të dialogut. Ju e dini se dialogu ka qenë një proces i zgjatur mirëpo, siç dihet, çdoherë kur jemi në fund të një procesi dalin propozime të ndryshme. AAK-ja asgjë nuk ka ndryshuar në qëndrimin e vet, Kosova i ka kufijtë e vet të njohur ndërkombëtarisht dhe mbi bazën e atyre kufijve rreth 115 shtete e kanë njohur Kosovën. Duhet të kihen parasysh se këto janë tema të ndjeshme dhe ka një lloj pasigurie në këto ide. T'ju them të drejtën, nuk e kuptojmë pse tani prezantohen këto ide. Mendoj se nuk kemi përgatitje dhe siguri në ide të tilla, qoftë të ndryshimeve të vogla të kufijve.

**"Epoka e re":** Pra, mendoni se Kosova duhet të bëhet pjesë e OKB-së me kufijtë aktualë?

**Kuçi:** Kosova raportet me NATO-n i ka krejt të veçanta dhe garantuesi kryesor për këta kufij është NATO-ja. Pra, Kosova ka avancuar me kufijtë ekzistues. Tani pse po ndodh kjo lëvizje për ndryshim të kufijve nuk jemi duke e kuptuar. Flitet se ka



# në bisedimet me Serbinë



ndërhyrje edhe të shteteve jomike që të na shtyjnë në një agjendë e cila për neve ka shumë të panjohura ose nuk është e analizuar mirë. Ne e patëm një debat në Kuvend për fazën e fundit të dialogut me Serbinë dhe si konkluzion i këtij debati ishte kërkesa e opozitës që kryeministri ta ketë një rol kyç në këtë epilog të dialogut. Pra, si rekomandim ishte që kryeministri t'i thërrasë liderët e partive parlamentare dhe ta krijojnë së bashku një platformë të bisedimeve në të cilën do të caktohet edhe formati i personaliteteve që do të shkojnë në këto bisedime. Po shpresoj që kryeministri do t'i thërrasë liderët e partive parlamentare dhe të bisedojnë ku pastaj do të dalin me një platformë e cila do të aprovohej në Kuvendin e Kosovës.

**"Epoka e re":** Ju jeni optimist se opozita do të jetë pjesë e fazës finale të dialogut?

**Kuçi:** Mendoj se ky proces është jashtë kornizave politike. Ne shpesh e kemi një garë të brendshme mes partive politike, mirëpo epilogu i dialogut me Serbinë duhet të jetë jashtë kësaj gare të zakonshme të brendshme politike. Nëse nuk e kuptojmë këtë atëherë diçka me partitë tona politike nuk është në rregull. Nuk ka kuptim që subjektet tona politike të mos ulen dhe ta krijojnë një platformë për këto bisedime dhe ta caktojnë formatin e bisedimeve se kush do ta përfaqësojë Kosovën në

këtë dialog. Ne nuk kemi nevojë ta marrim me vrysh këtë fazë, sepse Kosova është shtet i pavarur dhe funksional me kufijtë e vet dhe në këtë fazë ne duhet të hyjmë vetëm kur jemi unikë dhe të përgatitur.

**"Epoka e re":** Kur pritët që kryeministri t'i thërrasë në takim liderët partiakë për të diskutuar për këtë çështje?

**Kuçi:** Së pari të shohim se kërkesa e opozitës që kryeministri të marrë rol kyç në këtë proces është vetëm si deklaratë e zbrastë apo me të vërtetë kanë vullnet të takohen me kryeministrin dhe të diskutojnë për këtë temë. Mendoj se kryeministri vetëm e ka filluar këtë proces, mirëpo nuk duhet të ketë lojë të partive në këtë proces dialogues. Procesi i dialogut me Serbinë duhet të jetë jashtë kornizave dhe garës pozitive dhe opozitive. Në raport me këtë proces duhet të jemi të gjithë unikë dhe të ulemi të bisedojmë. Tanimë kryeministri ka një komunikim dhe pritjet vetëm të takohen për hartimin e një platforme për bisedime. Nëse një parti politike i ikën kësaj çështje atëherë diçka nuk është në rregull me atë parti, pra ajo parti qendrën e saj nuk e ka brenda, por jashtë Kosovës.

**"Epoka e re":** Opozita, të cilën ju po e ftoni të jetë pjesë e dialogut, vazhdimisht po kërkon rrëzimin e Qeverisë dhe shkuarjen në zgjedhje të reja?

**Kuçi:** Prej shpalljes së pavarësisë

tashmë kemi krijuar një traditë që opozita vazhdimisht të kërkojë zgjedhje të reja dhe këtë e bën për ta mbajtur elektoratin e vet aktiv, për t'i dhënë një shpresë atij se do të ketë ndryshime në mënyrën që ata kërkojnë. Mirëpo po më duket se kërkesa për zgjedhje të reja është e zbrastë edhe karshi kërkesave që ka Kosova tani. Ata e dinë se në këtë fazë roli i kryeministrit Haradinaj është i pashmangshëm, pavarësisht nëse ai është pozitë apo opozitë. Për fat të mirë, ai është tani në krye të ekzekutivit dhe ekziston mundësia t'i rregullojë këto gjëra më mirë dhe në mënyrë të duhur.

**"Epoka e re":** Sipas jush, kërkesa e opozitës për zgjedhje të reja është joserioze?

**Kuçi:** Është një standard i opozitës të cilën e njohim prej vitit 2008.

**"Epoka e re":** Po ashtu, është krijuar një traditë që, pas një periudhe gati njëvjeçare të një qeverie, të ndodhë riformatimi i kabinetit qeveritar. Mund të ndodhë tani ky proces?

**Kuçi:** Riformatimi i Qeverisë është një proces që varet prej vlerësimit të partnerëve të koalicionit qeverisës. Mendoj se fillimisht duhet të bëhet analiza e punës së sektorëve të ndryshëm qeveritarë, pastaj varet se si e vlerësojnë partnerët qeveritarë. Së paku, unë nuk kam njohuri se a mund të ndodhë një gjë e tillë. Edhe nëse ndodh duhet të shihet si diçka normale.

## Thaçi: Korrigjimi i kufijve, mundësia e vetme që Lugina t'i bashkohet Kosovës

PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë të martën se insistimi i tij për korrigjim të kufijve me Serbinë nuk nënkupton ndarje apo shkëmbim të territoreve. Ai ka thënë se me kohë e ka hedhur poshtë opsionin e ndarjes dhe të shkëmbimit të territoreve. "Një mesazh për ata që mendojnë se korrigjimi i kufijve në mënyrë paqësore është ide e keqe, përkundër faktit se e dinë që është mundësia e vetme që Presheva, Bujanoci dhe Medvegja t'i bashkohen Kosovës. Që të jem i qartë: Unë e kam hedhur poshtë me kohë opsionin e ndarjes dhe të shkëmbimit të territoreve. Unë jam duke folur vetëm për korrigjim të kufirit në mënyrë paqësore në favor të Kosovës.

Ndërsa kundërshtuesit e këtij propozimi propagandojnë për ndarje dhe shkëmbim të territoreve", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Në këtë kontekst, presidenti Thaçi ka thënë se është e domosdoshme e drejta e qytetarëve për të vendosur nëpërmjet referendumit. "Në një situatë të tillë vërtet që nuk mbetet rrugë tjetër përveç fuqizimit të vendimmarrjes së qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke iu mundësuar atyre për të vendosur vetë se kush ka të drejtë dhe se cili opsion është në interes të Kosovës. Prandaj, është e domosdoshme t'u mundësojmë qytetarëve tanë të drejtën e referendumit, gjë që për të cilën jam duke punuar që të bëhet realitet", ka shkruar Thaçi.





# Haradinaj priti në takim pjesëtarët e komunitetit egjiptian nga diaspora

PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Në kuadër të manifestimeve "Ditët e diasporës në Kosovë 2018", që janë duke u organizuar këto ditë, kryeministri i Ramush Haradinaj ka organizuar një pritje të veçantë për pjesëtarët e diasporës nga komuniteti egjiptian i Kosovës. Kryeministri Haradinaj ka thënë se përkushtimi dhe angazhimi i Qeverisë së Kosovës për të siguruar ambient të qetë, zhvillues dhe prosperues, për të gjithë qytetarët e saj, do të jetë i vazhdueshëm. "Edhe diasporën tonë, kudo që ndodhet, e ndiejmë pjesë tonën dhe do të

punojmë që dija dhe kapitali i saj të jetë në shërbim të vendit dhe atdheut tuaj", ka thënë Haradinaj, duke vlerësuar se komuniteti egjiptian në Kosovë është integruar dhe është pjesë e ndërtimit të atdheut tonë të përbashkët, Kosovës. Haradinaj, duke bashkëbiseduar me pjesëtarët e komunitetit egjiptian nga diaspora, ka kërkuar që të gjithë të angazhohen për përcjelljen e imazhit të mirë për vendin tonë, por edhe për sjelljen e praktikave të mira zhvillimore në vend. "Qeveria do të jetë në dispozicionin tuaj, në funksion të avancimit të mirëqenies së të gjithë

qytetarëve të saj, por edhe për realizimin e të gjitha të drejtave qytetare, njerëzore dhe kombëtare për shtetasit e Republikës së Kosovës", ka thënë Haradinaj. Pjesëtarët e diasporës së komunitetit egjiptian janë shprehur të kënaqur me angazhimin e kryeministrit dhe Qeverisë së Kosovës në raport me komunitetin egjiptian. Ata kanë shprehur një falënderim të veçantë për faktin se është hera e parë për një pritje dhe diskutim të çështjeve të tyre në nivel të lartë shtetëror të Republikës së Kosovës.



## Kryqi i Kuq i Kosovës ndihmon Klinikën Emergjente me ekipe vullnetare

**EPOKA  
ERE** Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 7 GUSHT - Është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), Klinikës Emergjente dhe Kryqit të Kuq të Kosovës në lidhje me pilot-projektin për formimin e ekipeve vullnetare për ndihmë të parë nga Kryqi i Kuq i Kosovës, ndihmesë për Klinikën Emergjente.

Nënshkrimin e memorandumit e bënë drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, Feride Hyseni, kryetare e Kryqit të Kuq të Kosovës dhe dr. Basri Lenjani, drejtor i Shërbimit Emergjent në QKUK. Marrëveshja parasheh formimin e ekipeve vullnetare të ndihmës së parë nga Kryqi i Kuq i Kosovës për Klinikën Emergjente, me qëllim që të ofrojë kujdes themelor për të sëmurë dhe të lënduar nga qasja e parë e pra-

nimit, vendosjen në barelë, karrocë dhe bartjen e tyre deri në dhomat e monitorimit, observimit, diagnostikimit dhe trajtimit.

Po ashtu, parashihet të sigurohet bashkëpunimi efektiv mes Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Klinikës Emergjente dhe Kryqit të Kuq të Kosovës, në lidhje me edukimin, trajnimin, certifikimin dhe licencimin e ekipeve vullnetare të ndihmës së parë të Kryqit të Kuq të Kosovës, të cilët do të qëndrojnë në shumicën e rasteve një hap para pranimit të shërbimit mjekësor emergjent spitalor.

Në memorandum theksohet se ekipet e Kryqit të Kuq do të asistojnë në përcjelljen e pacientëve së bashku me stafin mjekësor të Klinikës Emergjente. Ekipet vullnetare të ndihmës së parë të Kryqit të Kuq të Kosovës nuk kanë përgjegjësi profesionale gjatë trajtimit të sëmurëve dhe të lënduarve, por vetëm asistencë teknike.



## Mbi 200 të mitur të arrestuar për përdorim të drogave

PRISHTINË, 7 GUSHT - Në shtatë-mujorin e parë të këtij viti janë arrestuar 231 persona të moshës së mitur të cilët janë zënë duke abuzuar me substanca narkotike. Sipas policisë, për këtë periudhë kohore gjithsej janë arrestuar 1 200 persona për të njëjtën vepër penale. Në Kosovë llogaritet se janë rreth 25 mijë përdorues të substancave narkotike. Rreth pesë mijë prej tyre konsiderohet se janë përdorues aktivë të narkotikëve të ndryshëm.

Daut Hoxha, zyrtar për informim në Policinë e Kosovës, ka shpjeguar për "Radion Evropa e Lirë" se sipas rasteve të regjistruara në polici, moshë e personave që më së shumti konsumojnë droga të ndryshme është nga 21 deri në 35 vjet. "Nga të dhënat që ka Policia e

Kosovës, numri i konsumuesve të drogave dallon varësisht prej llojit. Numri i konsumuesve të heroinës ka rënë dukshëm e, po ashtu, edhe numri i rasteve të heroinës dhe qarkullimi i heroinës nëpër Kosovë në përgjithësi, ndërsa numri i konsumuesve të marijuanës është në rritje", ka thënë Hoxha.

Ai ka shtuar se për parandalimin e kultivimit të drogave policia ka realizuar patrullime me helikopterë në bashkëpunim me KFOR-in dhe EULEX-in, kontrollin e lokacioneve të dyshuara me dronë si dhe ka marrë informata nga qytetarët. "Kultivimi nuk është shumë i theksuar në Kosovë. Mbajllja bëhet kryesisht nga përdoruesit për përdorim personal në sasi të vogla, me ndonjë rast ku është tentuar të kultivohet në sasi më



të madhe, por ekzistojnë edhe vende ku kanabisi mbin vetvetiu (bimë të egra), vende të cilat Policia i ka identifikuar dhe bimët janë shkatërruar në fazën e hershme", ka deklaruar Hoxha.

Kosova njihet më shumë si vend transit për trafikimin e drogës dhe jo si destinacion. Safet Blakaj nga Qendra Mediko-Psikoterapeutike "Labirint" ka thënë se shqetësues mbetet fakti se në Kosovë në

vazhdimësi hyjnë droga të reja, e që përdoren nga të rinjtë pa pasur njohuri për to. "Edhe këtë vit po vazhdon trendi i përdorimit të drogave nga të miturit, pra nën moshën 18 vjeç. Kryesisht fillojnë përdorimin e drogës kanabis, pra marijuanës, por edhe disa droga të tjera të reja, siç është ekstazi dhe lloje të tjera. Këto janë drogat e lakmueshme nga adoleshentët", ka thënë ai, duke shtuar se një problem tjetër që i shqetëson janë barnat që mund të merren pa përshkrim të mjekut që blihen qoftë përmes tregut të zi apo në barnatore. "Këto po e rrezikojnë shëndetin e të rinjve", ka thënë Blakaj. Sipas Blakajt, droga 'GHB' (Hydroxybutyric acid) është duke u përdorur shumë nga të rinjtë në Kosovë.



# Lëvizja Vetëvendosje kërkon zgjedhje të reja

Deputetet e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci, kanë mbajtur të martën konferencë për medie, në të cilën kanë folur për zhvillimet e fundit politike në vend. Deputetja Nagavci ka thënë se është e domosdoshme që vendi të shkojë në zgjedhje dhe të krijohet qeveri e re



**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 7 GUSHT** - Deputetet e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci, kanë mbajtur të martën një konferencë për medie, ku kanë kërkuar që presidenti Hashim Thaçi të mos shkojë në Bruksel për të diskutuar për Kosovën në dialog me Serbinë. "Gjatë kësaj kohe ka pasur diskutime, ndonëse jo të qarta, lidhur me ekipin menaxhues, gjegjësisht draftin e statutit. Dje është thënë se ky draft-statut është proceduar në Bruksel dhe se do të jetë pikë diskutimi në takimin e ardhshëm Thaçi - Vuçiq", ka thënë Haxhiu, duke rikujtuar se Gjykata

Kushtetuese kishte konstatuar që 23 nene të Kushtetutës së Kosovës shkelen me marrëveshjen për "Zajednicën". Ajo ka thënë se ekipi i përbërë nga katër serbë, dy nga veriu dhe dy nga jugu, që ka vepruar në zyrat e OSBE-së në veri, është ekip jokushtetues. "Ato takime janë jokushtetuese. Çfarëdo dokumenti i prodhuar nga ky grup është jokushtetues dhe këtë duhet ta dijë edhe kryeministri që bën sikur nuk merr vesh, por edhe përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian apo secili ambasador që vepron në Kosovë. Kësaj i shtohet dhe fakti se ata persona konkretë që janë mbledhur për draftim të statutit janë aty sipas direktivave të Beogradit, pra janë kundër Republikës së

Kosovës", ka thënë deputetja Haxhiu. Ajo paralajmëruar protesta nëse presidenti Thaçi vazhdon ta takojë në Bruksel presidentin serb Aleksandër Vuçiq. "Hashim Thaçi nuk duhet ta takojë presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pasi ai nuk ka mandat nga Kuvendi i Kosovës, por as nga populli. Thaçi është figurë përçarëse.

Prandaj duke parë situatën aktuale, ne besojmë se është jashtëzakonisht e rëndësishme të ketë mobilizim gjithëpopullor. Edhe për ta ndalur Thaçin, por edhe për t'i ndalur dëmet që po na vijnë nga ky person. Prandaj këtu nuk përjashtohen protestat e as format e tjera që mund t'i bëjmë brenda Kuvendit të Kosovës", ka thënë

Haxhiu. Kurse deputetja tjetër, Arbërie Nagavci, ka thënë se është e domosdoshme që vendi të shkojë në zgjedhje dhe të krijohet qeveri e re. "Kosova ka nevojë për zgjedhje të reja. Kosova, po ashtu, ka nevojë për një president të ri që nuk frikësohet nga gjykatat dhe që bashkëndien me qytetarët", është shprehur ajo.

## Ministri Bytyqi kërkon nga kolegjet private t'i plotësojnë kushtet për akreditim

**PRISHTINË, 7 GUSHT (ER)** - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në një konferencë për media mbajtur të martën, ka reaguar ndaj letrës publike të Kolegjit ISPE, e cila i është drejtuar kryeministrit dhe institucioneve të tjera dhe është bërë publike në media, me arsyetimin se u është bërë e padrejtë nga ministri Bytyqi lidhur me mosakreditimin e këtij institucioni.

Ministri Bytyqi ka vlerësuar se kjo letër është e tipit të shantazhit, në mënyrë që të bëhet presion në institucionet shtetërore. "Nuk është i sotëm presioni që ky kolegji bën ndaj institucionit tonë. Ka pasur në vazhdimësi presione që në mënyrë të padrejtë të akreditohen programet, gjegjësisht të ndikohet në Këshillin Shtetëror të Cilësisë për akreditimin e programeve të këtij institucioni", ka

thënë ministri Bytyqi, ndërsa ka shprehur vendosmërinë të respektohen institucionet e pavarura. Ai ka thënë se është bërë një punë e jashtëzakonshme që të krijohet një Agjenci e Akreditimit dhe një Këshill Shtetëror i Cilësisë i pavarur dhe i pandikuar nga askush.

Ministri Bytyqi vlerësoi se është kërkuar vazhdimisht nga Këshilli i Cilësisë të respektohet ligji dhe procedurat dhe të jetë profesional në vendimarrje, gjë që edhe ka ndodhur me vendimet e marra deri më tani. "Vendimet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë janë vendime të pavarura nga ministri. Nuk mund të ndikojë ministri në vendimarrjen e këtij Këshilli", ka bërë me dije Bytyqi, duke treguar se në letrën e ISPE-së bëhet fjalë për vendimet e Këshillit dhe i adresohen ministrit. "Ne i bëjmë thirrje çdo insti-



tucioni që pretendon se ka pasur lëshime nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë, të orientohen tek organet kompetente, por se në asnjë mënyrë nuk do të lejojmë askënd të bëjë presione dhe shantazhe dhe si pasojë të kemi institucione joligjore që nuk i respektojnë ligjet dhe kriteret", është shprehur ministri Bytyqi.

Ministri i bëri thirrje Kolegjit ISPE të angazhohet për plotësimin e kushteve që parashihen me ligj dhe mos të bëjë presion as ndaj Ministrisë e as ndaj Këshillit. "Besoj se Këshilli nuk do të bjerë pre e këtyre manovrimeve për qëllime dhe përfitime personale", është shprehur Bytyqi, duke theksuar se Këshilli Shtetëror i Cilësisë do ta ketë përkrahjen e tij të rezervë nëse punën do ta bëjë në mënyrë profesionale dhe bazuar në kërkesat dhe procedurat ligjore.

## Suspendohen tre mjekë të OKUK-së, nuk ishin në vendin e punës

**PRISHTINË, 7 GUSHT (ER)** - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije të martën se janë suspenduar tre mjekë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) për shkak se gjatë inspektimit nuk kanë qenë në vendin e punës. Ai nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ka treguar se edhe tre punëtorë të

tjerë në QKUK janë në komision disiplinor.

Ismaili ka thënë se ka marrë njoftimin nga Bordi i ShSKUK-së se gjatë një inspektimi, të cilin e ka bërë drejtori i këtij institucioni, Basri Sedi, në disa klinika nuk i ka gjetur në vendin e punës disa mjekë dhe infermierë. "Si rrjedhojë, tre mjekë janë suspenduar

nga puna, tre të tjerë janë dërguar në Komision Disiplinor, përfshirë edhe dy infermierë. Duke e mirëkuptuar punën e vështirë dhe lodhjen e madhe që mund ta kenë gjatë ushtrimit të profesionit, mungesa në vendin e punës nuk e arsyeton askënd. Mungesa e tyre në vendin e punës mund të jetë humbje e

madhe për dikë", ka thënë Ismaili. Ai ka shtuar se MSH-ja është duke punuar çdo ditë që të përmirësohen kushtet për personelin mjekësor. "Këtë sjellje nuk e meritojnë mijëra profesionistë shëndetësorë të cilët e bëjnë punën e tyre me nder dhe përgjegjësi, që të njollosen nga raste të tilla. Prandaj, në këto sit-



uata nuk do të ketë kompromis dhe askush nuk do të falet", ka thënë ministri Ismaili.



## OEAK-u fton prodhuesit të përfitojnë nga lehtësirat tregtare me ShBA-në

PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka ftuar kompanitë prodhuese dhe përpunuese nga Kosova ta shfrytëzojnë statusin preferencial tregtar që Kosova gëzon me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në kuadër të të ashtuquajturit Sistem i Përgjithësuar i Preferencave (GSP) për t'i eksportuar produktet e tyre në ShBA. "GSP-ja është program tregtar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës i cili lejon importe të liruara nga detyrimet doganore

të mallrave nga shtetet përfituese, me qëllim promovimin e rritjes ekonomike në shtetet në zhvillim. Kosova bën pjesë në grupin e shteteve të pavarura në zhvillim të cilat përfitojnë nga GSP tash e disa vjet. Oda Amerikane njofton se presidenti i ShBA-së ka nënshkruar më 23 mars 2018 aktin ligjor i cili zgjat këto masa preferenciale tregtare për një numër shtetesh, përfshirë edhe Kosovën, për tre vjet të tjera, respektivisht për periudhën 1 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2020", është thënë në komu-



nikatën e OEAK-ut. Sipas kësaj komunikate, GSP-ja përfshin më shumë se 3 500 produkte që listohen sipas kodeve tarifore

që mund të eksportohen në ShBA nga shtetet përfituese pa iu nënshtuar detyrimeve doganore. "Produktet e përf-

shira në këtë program janë të natyrave të ndryshme, duke filluar nga produktet ushqimore, ato të tekstilit, plastikës, letrës dhe shumë industri të tjera të cilat prodhuesit në Kosovë mund t'i shfrytëzojnë. Oda Ekonomike Amerikane fton të gjitha bizneset e Kosovës të interesuara të eksportojnë në ShBA dhe të përfitojnë nga këto lehtësime doganore që ta kontaktojnë Odën Amerikane për informata më të detajuara lidhur me mundësitë e ofruara", është theksuar në komunikatën OEAK-ut.

## ATK-ja dhe FMN-ja, plan konkret për modernizimin e mëtutjeshëm



PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Të martën është mbajtur takimi përmblyës me përfaqësuesit e misionit të FMN-së, në të cilin është shpalosur plani i reformës së Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) për

periudhën 2019-2021. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e donatorëve të cilët mbështesin ATK-në.

Drejtori i ATK-së, Sakip Imeri, ka bërë me dije se aktivitetet e

përbashkëta u kanë shërbyer të njohin më mirë gjendjen e përgjithshme të përmbushjes tatimore, sfidat dhe pengesat, si dhe t'i caktojnë objektivat dhe prioritetet drejt funksionimit si një institucion

modern, i avancuar, profesional dhe i krahasueshëm me administratat tatimore moderne. "Në emër të ATK-së falënderoj FMN-në dhe gjithë donatorët për kontributin e dhënë në progresin tonë", ka

thënë Imeri. Ai ka shtuar se bashkëpunimi dhe shfrytëzimi i përvojave dhe ekspertizave të eksperteve të FMN-së dhe institucioneve të tjera ka sjellë progres të vazhdueshëm në ATK.

## Kadaj-Bujupi: Duhet kujdes i shtuar në politikat sociale

PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Donika Kadaj-Bujupi, ka vizituar të martën Odën e Afarizmit të Kosovës (OAK). Përfaqësuesit e OAK-ut e kanë përshëndetur iniciativën e deputetes Kadaj-Bujupi për projektrezolutën për shtesat e fëmijëve. Deputetja Kadaj-Bujupi ka theksuar rëndësinë që ka aplikimi i shtesave të fëmijëve, duke filluar me nga 10 euro në muaj për fillim për fëmijë, pastaj në të ardhmen kjo shumë pritet të rritet. Ajo ka thënë se kujdes i veçantë duhet t'u kushtohet edhe politikave sociale dhe faktit se në vendet e rajonit

shtesat e fëmijëve dhe stimulimet e tjera janë të aplikueshme.

Deputetja Kadaj-Bujupi ka bërë me dije se kanë bërë hulumtim lidhur me koston e këtij propozimi, e cila do të jetë rreth 80 milionë euro nga buxheti shtetëror. Sipas saj, kjo kosto është e përballueshme për faktin se investimet kapitale në infrastrukturë janë pothuajse drejt finalizimit. Kadaj-Bujupi ka përshëndetur edhe rekomandimet që OAK-u ka përgatitur për Ligjin e Punës, duke theksuar se në këtë formë stimulohet punësimi i grave në sektorin privat. Ajo ka thënë se do ta kenë përkrahjen e grupit parlamentar të AAK-së për këtë iniciativë.





Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, dhe ai i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, kanë vizituar të martën Odën Ekonomike të Kosovës (OEK)

# Hasani e Beqaj i ofrojnë përkrahje OEK-ut

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, gjatë takimit me kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, kanë diskutuar për bashkëpunimin në mes dy institucioneve dhe për adresimin e problemeve të bizneseve. Po ashtu, ata kanë diskutuar edhe për problemin e bizneseve me energjinë elektrike. Ministri Hasani ka thënë se nuk do të lejojnë që të luaj askush me bizneset dhe problemet e tyre do të trajtohen me seriozitet, e sidomos ato me energji elektrike



EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 7 GUSHT** - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka vizituar të martën Odën Ekonomike të Kosovës (OEK), ku është pritur nga kryetari Berat Rukiqi. Në këtë takim është diskutuar për bashkëpunimin në mes të dy institucioneve dhe për adresimin e problemeve të bizneseve. Ministri Hasani e ka uruar për detyrën e re Rukiqin, duke i shprehur gatishmërinë për bashkëpunim. "Sot e kemi pasur dëshirë ta vizitojmë kryetarin e ri, t'ia urojmë detyrën dhe t'i tregojmë që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe unë si ministër do ta fillojmë bashkëpunimin edhe më të thelluar, sepse mendojmë se Oda Ekonomike e Kosovës duhet të shihet si referencë kryesore e kontaktit për t'i shfaqur

shqetësimet e bizneseve", ka thënë Hasani.

Ministri Hasani ka bërë me dije se kanë diskutuar me Rukiqin edhe për problemin e bizneseve me energjinë elektrike. Hasani ka thënë se nuk do të lejojnë të luaj askush me bizneset dhe problemet e tyre do të trajtohen shumë seriozisht, e sidomos ato me energji elektrike. "Sa i përket KEDS-it, MTI është adresë që bizneset çdo ditë kanë ankesa për KEDS-in dhe ne jemi të interesuar ta gjejmë një modalitet që, ndoshta, përveç pikës së kontaktit, ta bëjmë që të jetë edhe pjesë e Këshillit Kombëtar, që të gjendet një mekanizëm, të formohet një grup që të ketë një mbikëqyrje më të rreptë për KEDS-in, apo kushdo qoftë ai investitor. Ne nuk jemi për t'iu përzier sektorit privat, por jemi për t'i mbrojtur bizneset dhe nuk lejojmë që

askush të luajë me bizneset tona. Faktet, ankesat dëshmojnë se KEDS-i i shfaq disa pengesa që duhet t'i adresojmë dhe t'i diskutojmë. Shumë biznese private kanë bërë investime me paratë e tyre dhe ai investim kalon në pronë të KEDS-it. Këtu ka mundësi shteti ta mbikëqyrë dhe nuk duhet të lejohen të keqtrajtohen. Këto duhet të trajtohen seriozisht", ka thënë ministri Hasani. Ndërsa kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka theksuar se ministri Hasani i ofroi bashkëpunim dhe gatishmëri për t'i adresuar problemet e bizneseve.

## OEK-un e vizitoi edhe ministri Beqaj

Edhe ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, i shoqëruar nga kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, ka takuar të martën drejtuesit e OEK-ut dhe përfaqësuesit e bizneseve, me qëllim të promovimit të programeve për financim të start-upeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) të lansuara ditë më parë. Gjithashtu, ministri Beqaj i ka informuar përfaqësuesit e bizneseve për punën dhe aktivitetet e Ministrisë për Inovacion dhe

Ndërmarrësi që nga themelimi i saj, me fokus në programet për financim të sektorit privat në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë të cilat e arrijnë vlerën 9.1 milionë euro për vitin 2018. "Synimi im kryesor dhe i Ministrisë është ndryshimi i konceptit ekonomik në Kosovë, në mënyrë që ekonomia të fokusohet edhe në ofrimin e shërbimeve. Faktori ynë kryesor në ndërtimin e konkurrencës janë shërbimet dhe për këtë Kosova ka potencial të madh, në veçanti në fushën e shërbimeve të teknologjisë, ku kemi të vetmin bilanc pozitiv tregtar", ka theksuar ministri Beqaj. Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka theksuar rëndësinë që ka përkrahja institucionale për bizneset. Në lidhje me këtë ai ka pohuar se Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë nuk do të marrë nga bizneset, por do t'u japë atyre. Gjatë bashkëbisedimit me përfaqësuesit e bizneseve ministri Beqaj ka sqaruar edhe qëllimin e ndarjes së fondeve për sektorin privat, që në harmoni me objektivat e MIN-së ka synim kryesor rritjen e kapaciteteve eksportuese të ndërmarrjeve të Kosovës dhe digitalizimin e prodhimit dhe shërbimeve. "E ardhmja e sektorit privat është digitalizimi në funksion të rritjes së prodhimit dhe shërbimeve", është shprehur ministri Beqaj. Ky takim i ministrit Beqaj në OEK është mbajtur me qëllim të promovimit të programeve financiare për përkrahje të start-upeve dhe NVM-ve.





## Shkarkohet nga bordi i NPB-së asamblisti i Vetëvendosjes

PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Asamblisti i Lëvizjes Vetëvendosje, Egzon Azemi, është shkarkuar nga bordi i aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB). Vendimi për shkarkimin e

Azemit është marrë nga Kuvendi Komunal i Prishtinës pas propozimit të asamblistit të Partisë Socialdemokrate (PSD), Nol Nushi, ndërsa në votim kanë marrë pjesë edhe asamblistët

e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Azemi është shkarkuar me 22 vota për, ndërsa me rastin e votimit të pranishëm në sallën e asamblesë nuk ishin asamblistët e LDK-së dhe Vetëvendosjes.

Pas shkarkimit të Azemit, Kuvendi Komunal i Prishtinës ka zgjedhur dy përfaqësues të ri për bordin e NPB-së, Genc Sherfin nga PSD-ja dhe Suzana Kika nga AAK-ja.



## Trashëgimi kulturore, jo vendparkingje

PRIZREN, 7 GUSHT (ER) - Të martën është finalizuar iniciativa "Trashëgimi kulturore, jo vendparkingje!" e konceptuar nga pjesëmarrësit e Shkollës së Aktivizmit Urban në kuadër të projektit "Rikthimi i qytetit". Kjo iniciativë ka për qëllim ta potencojë problemin e parkimit të automjeteve në afërsi të objekteve të trashëgimisë kulturore (ndër të tjera, në afërsi të Xhamisë Sinan Pasha, në afërsi të Urës së Gani Tadës, në afërsi të Muzeut Arkeologjik etj). Kjo praktikë, përveçse kufizon qytetarët në lëvizje, dëmton rëndë imazhin e qytetit në përgjithësi dhe të objekteve të trashëgimisë kulturore në veçanti. Parkimi në afërsi të perimetrit të objekteve të trashëgimisë kulturore pengon vizurat ndaj vlerave të trashëgimisë, qasjen në objektet

kulturore si dhe ndikon në dëmtimin e peizazhit kulturor. Rrjedhimisht, kjo problematikë ndikon jo vetëm te qytetarët e Prizrenit, por edhe te turistët dhe vizitorët e shumtë të qytetit tonë. Lidhur me këtë problematikë, EC ka intervenuar në rrugën "Vatra Shqiptare", e cila lidh Kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit si dhe Kompleksin e Marashit, duke vendosur pengesa në formë të ulëseve, të cilat do t'i zëvendësojnë automjetet e parkuara në këtë zonë edhe pse një gjë e tillë është e ndaluar. Kjo iniciativë do të përcillet me iniciativat e radhës të dizajnuara në kuadër të Shkollës së Aktivizmit Urban. Veprimet e propozuara trajtojnë çështje të caktuara të komunitetit në qytet dhe u takojnë fushëveprimeve të ndryshme me fokus në hapësirat publike.



## Nisin punimet për sinjalizimin horizontal dhe vertikal të rrugëve në Rahovec

RAHOVEC, 7 GUSHT (ER) - Në Komunën e Rahovecit kanë nisur punimet në projektin për sinjalizimin horizontal dhe vertikal të rrugëve. Ky projekt do të zbatohet nëpër disa rrugë duke u bazuar edhe në kërkesat e qytetarëve.

Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike për fillimin e punëve në projektin e sinjalizimit horizontal dhe vertikal të rrugëve, Përparim Krasniqi, ka potencuar se kompania e kontraktuar nga komuna fillimisht është duke bërë pike-timin në disa prej rrugëve kryesore si në rrugën "Xhelal Hajda-Toni" nga hyrja kryesore e qytetit në drejtim të rrugëve rajonale Rahovec-Drenoc. Krasniqi ka bërë me dije se në



kuadër të këtij projekti do të bëhet edhe vendosja e pengesave në rrugë, tabelat informuese për vendbanimet dhe tabelat për ruajtjen e mjedisit. Mbikëqyrja e realizimit të pro-

jektit do të bëhet nga Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Punë Inspektuese, Policia e Kosovës dhe ekspertët nga fusha e komunikacionit.

## Gjilani pranon 20 laptopë donacion nga Zvicra

GJILAN, 7 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pranuar të martën 20 laptopë për shkollat profesionale, që është donacion i organizatës zvicerane "Labdoo". Në emër të kësaj organizate donacionin ia dorëzuar kryetarit Haziri, koordinatori i "Labdoo"-s, Asdren Toska. Me këtë rast kryetari Haziri ka falënderuar koordinatorin Toska për iniciimin dhe përkushtimin që ky donacion të

vijë në qytetin e tij, duke thënë se laptopët do të shfrytëzohen nga shkollat profesionale pasi do të ketë ndikim në përmirësimin e cilësisë në institucionet edukativo-arsimore. Ndërsa koordinatori i organizatës zvicerane "Labdoo", Asdren Toska, ka njoftuar se ky është vetëm fillimi i donacioneve të kësaj natyre. Ai ka premtuar se brenda vitit edhe 200 laptopë të tjerë do t'i sjellë në Gjilan.



## Begaj jep vlerësim pozitiv për organizimin e festivalit "Oda e Llapushës"

MALISHEVË, 7 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur në takim këshillin organizativ të edicionit të pestë të Festivalit Folklorik "Oda e Llapushës". Me këtë rast Begaj ka falënderuar këtë këshill për punën dhe angazhimin në orga-


nizimin e këtij festivali. "Pavarësisht se kam qenë në një vizitë zyrtare në Gjenevë, festivali i folklorit është një prej aktiviteteve më me rëndësi për mua në fushën e kulturës. Me mendje kam qenë këtu, andaj ju përgëzoj të gjithëve për

organizimin dhe realizimin e suksesshëm të festivalit", ka thënë Begaj. Po ashtu, Begaj i ka uruar të gjithë fituesit e festivalit dhe pjesëmarrësit, të cilët i kanë dhënë jetë këtij festivali përmes prezantimit të kulturës dhe vlerave të larta artistike.





# Shkëmbimi i territoreve



Rexhep QOSJA

Kjo çështje nxiti shumë paraqitje individuale e partiake në Kosovë, por edhe në Shqipëri. Dhe këto paraqitje sollën disa koncepte, nocione dhe togfjalësh politikë. Koncept kryesor i këtyre diskutimeve u bë togfjalëshi ndarja e Kosovës. Prej diskutimeve rreth këtyre koncepteve, nocioneve e togfjalëshave shihet se disa prej autorëve nuk i kuptojnë, kurse disa të tjerë i keqkuptojnë, mund të jetë qëllimisht. Mund të them se ata që kanë përdorur konceptin e shkëmbimit të territoreve dhe ata që kanë përdorur konceptin e korigjimit të kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk kanë menduar në asnjë mënyrë, dhe kurrë, për ndarje të Kosovës. Shkëmbimi i territoreve dhe korigjimi i kufirit nuk nënkuptojnë ndarje të Kosovës. Shkëmbimi i territoreve dhe korigjimi i kufirit nënkuptojnë lëvizje, në të vërtetë ndryshim të kufijve në skajet të Kosovës, në skajin verior të Kosovës.

Për çdokënd që mendon racionalisht, me të dhëna, me argumente, me të vërteta e të drejta në mendje, togfjalëshi ndarje e Kosovës do të thotë ndarje e Kosovës, që do të bëhet me një kufi i cilido të shtrihet nëpër Kosovën e kufijve që ka ajo sot.

Të përsëris: shkëmbimi i territoreve dhe korigjimi i kufirit nënkuptojnë ndryshim vetëm të

kufirit të skajshëm verior të Kosovës e jo ndarje të Kosovës.

Pse atëherë ata që iu vardisën mosekzistueses, ata akuzues për ndarje të Kosovës po i akuzojnë për ndarje ata që këtë kërkesë në asnjë mënyrë nuk e bënë?

Mund të jenë disa arsye për këtë. E para, mosdija. E dyta, inatet, që shpesh përcaktojnë përmbajtjen e mendimeve të disave prej atyre akuzuesve dhe, e treta, ndoshta kryesorja, përpjekja për ta pastruar jetëshkrimin e vet politik në të kaluarën e tyre të derivonshme.

Them kështu për shkak se ndër këta akuzues që akuzuan disa ish-prijës politikë e ushtarakë të UÇK-së, që më në fund i sollën lirinë dhe pavarësinë Kosovës natyrisht në sajë të ShBA-së dhe Bashkimit Evropian; ndër këta akuzues që akuzuan kryeministrin e sotëm të Shqipërisë, Edi Ramën, i cili është politikani i vetëm në historinë e marrëdhënieve në mes të Shqipërisë e Serbisë dhe Shqipërisë e Greqisë që Serbisë e Greqisë ua tha të vërtetat më të rënda që nuk ua kishte thënë as një politikan shqiptar në Tiranë apo në Prishtinë deri sot, nuk është e çuditshme se ndër këta akuzues, që akuzën e tyre e bazuan në ndarje të Kosovës, pra pati të tillë që Kosovën e ka quajtur territor të binekëve, domethënë territor gjysma e të cilit i takon Serbisë e gjysma tjetër i takon Kosovës dhe ashtu e mohonte çdo mundësi për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Për këtë arsye kundër tij shqiptarët në Evropë bënin protesta duke e quajtur tradhtar kombëtar.

Ndër këta akuzues pati të tillë që si pjesëmarrës në pushtetin e Kosovës në kohën e dhunës e terrorit të regjimit të Millosheviqit në Kosovë morën pjesë në urdhërdhëniet për shuarjen e

demonstratave të rinisë shqiptare të Kosovës me ç'rast u vranë dhjetëra të rinj.

Ndër këta akuzues pati të tillë që në kohën e dhunës e terrorit të regjimit të Millosheviqit i shërbyen Sigurimit Shtetëror të atij regjimi me informacionet më akuzuese, në të vërtetë armiqësore ndaj UÇK-së dhe luftës çlirimtare në Kosovë në përgjithësi. Ndër këta akuzues pati të tillë që si prijës partiakë në vitet e '90-ta dhe si gazetarë e publicistë në atë kohë e mohuan çdo mundësi jo vetëm për pavarësinë, por edhe për ngritjen e statusit të Kosovës në Republikë në kuadrin e Federatës apo Konfederatës Jugosllave.

Ndër këta akuzues pati të tillë që morën pjesë në hartimin e programeve të partive të tyre, që u regjistruan në ministrinë përkatëse të Beogradit dhe që mohonin çdo rezistencë aktive dhe që ardhmërinë e Kosovës e shihnin në lidhje shtetërore me Jugosllavinë e mbetur e kjo domethënë më në fund me Serbinë.

Ndër këta akuzues që u ngrehën kundër idesë së ndarjes së Kosovës të cilën nuk e kërkuan të akuzuarit u ngrehën edhe një intelektual dhe një intelektuale në Tiranë, por u ngrehën me një gjuhë të butë e të ngatërruar me të cilën, megjithatë, thanë çka atyre, për shkak se janë njohës të jashtëzakonshëm të marrëdhënieve shqiptaro-serbe, nuk u kishte hije që ta thoshin.

Për të gjitha këto arsye pjesëmarrjen e këtyre akuzuesve në diskutimet që po bëhen për bisedimet e ardhshme të quajtura përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë, sipas mendimeve të mia, nuk do ta marrë seriozisht. Në asnjë mënyrë unë këtyre akuzuesve nuk ua mohoj të drejtën t'i ndërroj mendimet e

tyre të dikurshme, të cilat, ç'është e vërteta, i kanë ndërruar pas çlirimit të Kosovës prej pushtimit të Serbisë, por ua mohoj të drejtën që t'i akuzojnë të tjerët në vend se vetveten e dikurshëm.

Seriozisht do marrë, ndërkaq, këshillimet e dy të parëve zyrtarë të sotëm të Kosovës me disa analfabetë, në mënyrë të veçantë këshillimet me analfabetin e parë, të kryekorruptuar, të Akademisë së Shkencave e të Arteve të Kosovës, të cilin me gishtin e tyre tregues e bënë kryetar të asaj Akademie partiake e private me qëllim që të mund ta përdorin atë Akademi siç e përdorën më në fund në bisedimet për një marrëveshje ndërshtetërore cenusese për Kosovën tashmë të miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Seriozisht duhet marrë këtë çështje: çështjen e delegacionit shqiptar që po merr pjesë dhe që do të marrë pjesë në bisedimet në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Kosova ka historianë, ka juristë, ka gjeografë, ka antropologë, ka politikanë, ka intelektualë, me përgatitje të ndryshme historike e të përtrashme për të gjitha problemet e çështjet që mund të ngrehën në ato bisedime. Por në grupet që deri tani biseduan në Vjenë e në Bruksel e që po bisedojnë edhe tani në Bruksel për marrëveshjen mes Kosovës e Serbisë pothuajse mbizotërojnë diletantët. Prej tyre jo pse nuk do të donin, por pse nuk dinë, nuk mund të pritën ndonjë e mirë për Kosovën.

Ata që po programojnë bisedimet me Serbinë dhe ata që morën pjesë në diskutimet për shkëmbim të territoreve dhe korigjimit të kufirit do të duhej ta dinë një gjë: faktorët ndërkombëtarë zakonisht në bisedimet mes dy palëve nuk lejojnë që një palë të jepet çdo gjë e

palës tjetër asgjë.

Ata që po i programojnë bisedimet me Serbinë dhe ata që morën pjesë në diskutimet për shkëmbim të territoreve do të duhej të përpiqen e të mësojnë se shkëmbime të territoreve, madje në disa raste edhe të pjesëve të popullatës në mes dy shteteve, janë bërë gjatë historisë. Dhe janë bërë madje dhe jo shumë larg në kohë edhe në Ballkanin Juglindor.

Ata që po merren me çka u tha më sipër do të duhej që më në fund të dinë se faktorët e mëdhenj ndërkombëtarë zakonisht nuk i kundërshtojnë pajtimet mes dy shteteve e dy popujve qoftë edhe kur me to preken disa parime të përgjithshme që ato politikisht i mbrojnë.

Ata që po merren me çka u tha më sipër, në mënyrë të veçantë ata që po predikojnë retorikën e korigjimit të kufirit, domethënë të bashkimit të Luginës së Preshevës me Kosovën, do të duhej të dinë se faktorët ndërkombëtarë nuk do t'u pranojnë të drejtën e vetëvendosjes shqiptarëve të Luginës së Preshevës dhe t'ua mohojnë të drejtën e vetëvendosjes serbeve të Veriut të Kosovës.

Le të thuhet në fund, prandaj, se ata që janë kundër shkëmbimit të territorit në mes të Luginës së Preshevës duke përfshirë Preshevën, Bujanocin e Medvegjën dhe Veriut të skajshëm të Kosovës, të Mitrovicës, dëshën apo s'dëshën po ia dhurojnë Serbisë edhe njëherë edhe tjetër: Luginën e Preshevës si pjesë të Serbisë, kurse Veriun e Kosovës si autonomi substanciale (si pavarësi) në të cilën pushtetarët e Kosovës, si edhe tani, do t'i përkulen monumentit të madh të Knjaz L Lazarit.

(Shkruar për dritare.net)

## Prokuroria Speciale ka paraqitur aktakuzë ndaj një serbi për krime lufte

PEJË, 7 GUSHT - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka njoftuar përmes një komunikate për media se më 3 gusht ka paraqitur aktakuzë në Departamentin për Krime të Rënda në Gjykatën Themelore të Pejës kundër të pandehurit serb M. Z. për shkak se në bashkëkryerje me një grup personash të panjohur, i njëjti ka kryer veprën penale të krimeve të luftës në kundërshtim të rëndë me Konventën e Gjenevës. Sipas komunikatës, M. Z. aktualisht është penalizuar sipas neneve 31 dhe 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Në aktakuzën e PRSK-së i pandehuri gjatë periudhës qershor-korrik 1998 ka marrë pjesë aktive në sulmet e organizuara kundër

popullatës shqiptare nga pjesëtarë të forcave serbe në fshatin Dush të Komunës së Klinës.

Organizatrat joqeveritare kanë dorëzuar edhe më herët kallëzime penale për, siç janë shprehur, krime të luftës në Kosovë. Javën e kaluar përfaqësuesit e Grupit të Shoqërisë Civile për grumbullimin e dëshmimeve për krime lufte kanë dorëzuar 82 kallëzime penale në Prokurorinë Speciale të Kosovës.

Kryetarja e këtij grupi, Mevlyde Mezini-Saraq, ka thënë se më 3 gusht kanë dërguar kontingjentin e gjashtë me kallëzime penale drejt institucioneve të drejtësisë "kundër kriminelëve serbë të cilët kanë kryer krime lufte kundër popullatës së Gjakovës".





## Boltoni: Peniani nuk po bën hapa për çnuklearizimin



WASHINGTON, 7 GUSHT - Këshilltari amerikan i Sigurisë Kombëtare, John Bolton, akuzoi Korenë e Veriut se nuk po bën hapa për çnuklearizimin e premtuar nga udhëheqësi i Phenianit, Kim Jong Un, në takimin me presidentin Donald Trump në Singapor në muajin qershor. "Ajo që na duhet nuk është më retorika", tha Boltoni.

"Ajo që na duhet janë rezultate nga Koreja e Veriut për çnuklearizimin", tha ai. Ai tha se që nga takimi i Singaporit, Koreja e Veriut "nuk ka ndërmarrë hapat që ne mendojmë se janë të nevojshme për çnuklearizimin". Boltoni tha se ShBA-ja nuk po shikon mundësinë e zbutjes së sanksioneve ekonomike kundër Phenianit.

Zyrtari i Shtëpisë së Bardhë tha se presidenti Trump, në një letër të kohëve të fundit për udhëheqësin Kim Jong Un, propozoi dërgimin e Sekretarit amerikan të Shtetit Mike Pompeo në Phenian për bisedime të mëtejshme. Trumpi u shpreh se ishte i gatshëm të mbante një takim të dytë me udhëheqësin koreanoverior.

# Hyjnë në fuqi sanksionet amerikane ndaj Iranit

Presidenti amerikan Donald Trump tha se rivendosja e sanksioneve ndaj Iranit do të thotë: "Kushdo që bën biznes me Iranin nuk do të bëjë biznes me Shtetet e Bashkuara". Sanksionet e ashpra ekonomike e rrisin presionin ndaj Republikës Islamike, pavarësisht prej deklaratave të aleatëve evropianë të cilët shprehnin keqardhje të thellë



WASHINGTON, 7 GUSHT - Shtetet e Bashkuara rivendosën sanksionet ekonomike ndaj Iranit, të cilat fillimisht u imponuan që Teherani ta kufizonte programin e tij bërthamor dhe më pas u hoqën në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare në vitin 2015.

Presidenti Donald Trump ka qenë kritik i shpeshtë i marrëveshjes dhe i tërhoqi Shtetet e Bashkuara prej saj tre muaj më parë, duke rivendosur sanksionet të cilat hynë në fuqi mbrëmë në mesnatë. Në fillim të nëntorit pritet të hyjnë në fuqi sanksione të tjera amerikane që synojnë sektorin iranian të naftës dhe bankën e tij qendrore.

Në një koment në "Twitter", presidenti Trump shkruante se rivendosja e sanksioneve do të thotë: "Kushdo që bën biznes me Iranin nuk do të bëjë biznes me Shtetet e Bashkuara".

"Unë po kërkoj paqe në botë, asgjë më pak!" shkruante ai. Sanksionet e ashpra

ekonomike e rrisin presionin ndaj Republikës Islamike, pavarësisht prej deklaratave të aleatëve evropianë të cilët shprehnin keqardhje të thellë. Presidenti Trump ka thënë se marrëveshja historike e 2015-s ishte e tmerrshme, sepse i dha qeverisë iraniane fonde për t'i ushqyer konfliktet në Lindjen e Mesme.

Irani akuzoi Shtetet e Bashkuara për tërheqjen nga marrëveshja bërthamore, e nënshkruar nga administrata Obama si dhe për krijimin e kaosit në ekonominë iraniane. Në një deklaratë të bërë në prag të rivendosjes së sanksioneve, presidenti Trump tha: "Ne u bëjmë thirrje të gjitha vendeve të ndërmarrin hapa të tillë që e bëjnë të qartë se regjimi iranian përballet me një zgjedhje: ose ta ndryshojë sjelljen kërcënuese, destabilizuese dhe të riintegrohet me ekonominë globale, ose ta vazhdojë rrugën e izolimit ekonomik".

Trumpi paralajmëroi se ata që

nuk i shkëpusin lidhjet e tyre ekonomike me Iranin rrezikojnë pasoja të rënda.

Pavarësisht nga pretendimet e Trumpit, marrëveshja po funksionin dhe po e realizon qëllimin e saj për kufizimin e programit bërthamor të Iranit, tha një deklaratë shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini dhe ministrat e Jashtëm të Francës, Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar.

Ministrat thanë se marrëveshja

për Iranin është "vendimtare për sigurinë e Evropës, rajonit dhe të gjithë botës". Bashkimi Evropian shpalli një statut bllokimi të hënën për t'i mbrojtur bizneset evropiane nga ndikimi i sanksioneve.

Një zyrtar i lartë i administratës, duke informuar gazetarët në kushte anonimiteti, tha se Shtetet e Bashkuara nuk janë "veçanërisht të shqetësuara" nga përpjekjet e BE-së për t'i mbrojtur firmat evropiane nga sanksionet.

Presidenti iranian Hassan Rouhani tha se Irani mund të mbështetet te Kina dhe Rusia për të mbajtur në këmbë industrinë e naftës dhe të sektorit bankar. Duke folur në një intervistë televizive, ai kërkoi kompensim për "ndërhyrjen" amerikane ndaj Republikës Islamike për dekada të tëra. Muajt e pasigurisë kanë dëmtuar më tej ekonominë e Iranit. Monedha e vendit ka rënë mjaft dhe kjo ka shkaktuar protesta anembanë vendit.

## NATO zhvillon manovra ushtarake në Gjeorgji



TBILISI, 7 GUSHT - Gjeorgjia është organizatorja e një stërvitje ushtarake në shkallë të gjerë me pjesëmarrjen e mijëra trupave të NATO-s. Manovrat e koduara "Noble Partner" që po zhvillohen në një bazë pranë kryeqytetit Tbilisi përkohësisht me dhjetëvjetorin e ndërhyrjes së Rusisë në Gjeorgji. Në manovrat e sivjetshme marrin pjesë mijëra trupa nga NATO-ja, ndërsa afrohet dhjetëvjetori i luftës së Gjeorgjisë me Rusinë. Kjo është hera e katërt që NATO-ja zhvillon stërvitje ushtarake në shkallë të gjerë. Kapiteni Mathias Sturmer është komandant i kom-

panisë gjermane. "Detyra e kompanisë sime tokësore të blinduar ishte që ta siguronim perimetrin përreth objektivit në unison me forcat amerikane, ukrainase, gjeorgjiane dhe lituaneze. Në këtë mënyrë faza tjetër e operacionit do të kurorëzohej me sukses", tha ai. Manovrat dyjavore të gushtit përkohësisht me 10-vjetorin e ndërhyrjes së Rusisë në Gjeorgji dhe konfliktit të shkurtër që pasoi. Rusia vazhdon të mbajë trupa dhe ta mbështesë territorin që pushtoi, duke njohur shtetet separatiste, Osetia e Jugut dhe

Abkhazia. "Ushtarët amerikanë dhe gjermanë drejtuan një sulm të simuluar ndaj forcave gjeorgjiane. Manovrat e koduara "Noble Partner" janë të katërtat e këtij lloji që zhvillohen me forcat e armatosura gjeorgjiane, me ushtritë evropiane dhe amerikane. Synimi është mbështetja dhe përmirësimi i kapaciteteve të vendeve pjesëmarrëse dhe atyre rajonale si dhe gatishmëria dhe ndërveprimi gjatë operacionit shumëkombësh të trajnimit", tha Havlego Tabatadze, gjeneral brigade i forcave gjeorgjiane.





## Ronaldo dhe Georgina "shopping" në Milano

**C**ristiano Ronaldo dhe e dashura e tij Georgina Rodriguez janë para në Milano të kapur dorë për dorë. Ata po blinin në Milano dhe nga fotografi duket se Georgina është mjaft e trullësuar. Ylli portugez dukej shumë trendi veshur me një këmishë të bardhë, xhinse dhe mbante në kokë një kapele. Ndërsa brunja bukuroshe kishte nxjerrë në pah këmbët, veshur me pantallona shumë të shkurtra.

## Gigi Hadid, varëse me emrin e Zayn në qafë



**G**igi Hadid dhe Zayn Malik prej tre vjetësh kanë pasur një lidhje jo shumë të qëndrueshme. Herë pas here ata i kanë dhënë fund lidhjes së tyre, por sërish janë rikthyer në krahët e njëri-tjetrit. Mirëpo, duket se Gigi është e dashuruar marrëzisht

pas Zayn. Modeluesja e famshme është fotografuar teksa mbante një varëse ku shkruhej emri i Zayn. 23-vjeçarja u shfaq e mrekullueshme në krah të të dashurit të saj. Duket se rikthimi i tyre së bashku është më i fuqishëm se kurrë.




## Rita Ora, "fansja" më e re e PSG-së

**A**jo është e njohur për një ndjenjë unike të stilit të veshjes. Sidoqoftë, Rita Ora hodhi një hap më tutje teksa ishte veshur me një ansambël ngjyrash, të frymëzuar nga bota e futbollit,

teksa iu drejtua zyrave të "BBC Radio One". Këngëtarja e hitit "Girls" me siguri i bëri të gjithë t'i kthenin sytë nga veshja e saj e mrekullueshme, ku dominonte fanella e klubit të futbollit Paris Saint Germain.

## Neymari, më i dashuruar se kurrë

**K**ohët e fundit ka qenë shpesh në qendër të vëmendjes për simulimet apo dështimet në Botëror. Por, kur është në shoqërinë e Bruna Marquezinhe, Neymar nuk do t'ia dijë për asgjë. Me zemër dhe mendje i përkushtohet të fejuarës së tij. Me rastin e ditëlindjes së saj, pak kohë më parë, Neymari i dedikoi një mesazh të ëmbël, duke i kujtuar se është shumë me fat që e ka në krahë.





# TE DARDHA E METIT

(Kushtuar shkrimtarit të ndjerë, Mehmet Kajtazi, ose qasje për ta hapur portën e një jetëshkrimi...)



**Riza GREIÇEVCI**

1. Në katundin, Shpati, një pjesëtokë e Dardanisë të motit 2018, Fillimshekulli i Ri për hatër të Vlorës, Krujës, Çamëri për hatër të nënës Zelfie, babë Aliut për hatër të Heroit të Kombit, Skënderbe për hatër të Dardhës së Metit, e mbolli gjyshi Li sot po afrohen yjet, qielli e toka ma ngatë hapet Shtëpia e Diellit, e para në Planetin Tokë këtu ku prehet në paqe shpirt i gjyshit Met bën me dije mbesa poete, Marena Kajtazi, vetë!

Shpesh shëtisim mbi krahë të poezisë unë, mbesa Marena, dhe im gjyshi Meti fluturonim gjithandej ku jetohej, vdiset shqip vizituam Çamërinë, edhe Dardhën e Metit edhe Varrin e Adem Jasharit edhe djallarët e gjyshit, në Klinë të Epërme edhe Vitakun, u takuam me bacën Lilë edhe mendtarin Mujë Loshi e vizitonim edhe Pemishtën, Kotorrin, Radishevën edhe Izbicën, Kopiliçin, Lekajn, Likocin e u takonim me plakun Dërvish Goxhuli:

"Dikujt i duhet nën gjuhë një kokërr pasuli"

3. Më se shpeshti e pyesja gjyshin, Met pse gjithë ditën e, që besa, bota krejt po, po, edhe unë, Marena, e kam parë kushedi pse rrallë rrinte n'odë tepër rrallë pushonte në hije të fllanikut tepër rrallë mbështetej për stogu t'sanës tepër rrallë hante kokrra të dudat tepër rrallë ulej në hije të arrës eeeee, pa lindur dielli zgjohej gjyshi im Meti e përcillte nga oborri një e lehur këlyshi me do libra, fletore, lapsa, gazeta i thoshte shtëpisë: "Djepi, sofrë ime, tungjatjeta!" motër Fatmirja ia binte sillën vëlla Sheremeti tre herë në ditë i binte duhan motër Nexhmija, në mesditë, sillte drekën motër Adillja sillte kajsia, kumbulla, duda... vëlla Fazliu, Meti, i sillte ujë biseda e Nanës Zelfie, me djalin e madh, Metin ishte e gjatë, sot e asaj dite, askush s'e di sekretin!

Tërë ditën e lume, karshi dritares s'e mori vesh askush nga Shpati ç'bisedonin, gjyshi Meti, dhe Dardha herë qeshnin, herë-herë dëgjohej piskama: "Mëso të dish shumë, o i biri Ali Kajtazi,

por mos ia thuaj të gjitha ato që i di: as hasmit, as mbretit, as krajlit!"

4. Më tutje, rrëfente mbesa e Mehmetit si një flutur lozonjare Mirena e Besit miku im i profesionit, i penës, maleve, i dertit ç'i kishte thënë mbesës, Marena, për Dardhën aty ku e çonte kohën ditën, shpesh edhe natën: Kjo dardhë, ballaballë dritares së shtëpisë është sofër ku ha bukë, pi ujë, rri me Shqipërinë fshehtësitë e saj s'ia tregoi askujt kjo dardhë është oxhaku, ku i pjek mendimet degët e Dardhës janë kompjuter i shkruaj shkrimet nga Kosova n'Goli-Otok kjo dardhë është çifteli e Sali Manit kënga e rapsodit, amanet, djalë pas djalit:

"Pa Shqipëri s'ka Kosovë, pa Kosovë s'ka Shqipëri!"

Nën kurorën e kësaj dardhe, la kujtim Meti: nga kjo dardhë i pashë plisat e bardhë në Tivar të përgjakur, koka, duar, copa mishi t'shqiptarit nga dardha pashë Bacin Li, me cigarlluk t'qelbarit bashkëluftëtar i komandant Shabanit pashë shpirtin e gjyshit tim fytafyt me kriminelët e masakrës së Tivarit nga kjo dardhë shihet Shqipëria, Krujë, Vlorë nga kjo dradhë shihen yjtë, planete, meteorë nga kjo dardhë shihet Evropa me shtatë koka të mos harrosh, ime mbes, Marena nën kurorën e kësaj dardhe, dolën në jetë:

"Nata në gur", "Plaku dhe urat", "Fundi i legjendave", "Shqiptarët në Goli-Otok", "Ushtrimë e Alboderit", "Shote Galica", "Minatorët", "Thikë në portokall", "Gjeli i katedrales", "Santa Ana", "Guri i dallëndyshes", "Lindja në qiell", "Udha i", "Ndezja e shiut", "Një diell tjetër" "Zemër e thyer" dhe "Kodra e Pajtimit".

5. Vetëm sa kishte mbaruar moti 1970 Mehmet Haziri, nga Leçina erdhi në vendlindje Sankoc, të me shihte si dukësja mësues bashkë vizituam varrin e poetit e mësuesit Fazli unë, ballë varrit të kushlëririt tim poetit Mehmet ia lexova dy rreshta poezi:

"Le të përzihen tokë edhe det, o kush nuk vdes për flamur të vet!"

(Vargje nga libri im (1991) për Fazliun: "Flamur nga Drenica")

Me mikun tim të profesionit, të penës, maleve, Metin u takuam në lokal "Arabeska", në Prishtinë i kishin pëlqyer vargjet e poezisë sime "Ato me plisa të bardhë", me shtrëngoi për gjoksi, shpërthej me zë prej burri: "Ti s'di me shkruar poezi... dil me një libër të ri" Fati e deshi, faleminderit, o Perëndi,

u bëmë miq të profesionit, të penës, të maleve në gazetën "Rilindja", gazetar që të dy por, unë, për besë, s'isha as hija e tij!

6. Kur fliste, gjyshi Meti, fliste ëmbël kur qeshte, qeshte ëmbël kur këndonte, këndonte ëmbël kur thërriste nanë, e dëgjonin yje dhe hanë kur thërriste Shqipëri, shembej ai gjarpër kufi kur thërriste: Drenicë, ushtonin lugjet e Qyqavicës dëgjohej pushkë e Emin Latit, Shotës, Azem Galicës kur thërriste Fehmi, Xhevë, Agim, Adem Jashari fliste fuqishëm, si rrufeja:

"Në odën e Shaban Jasharit u lind UÇK-ja!"

fjalën s'e hidhte si top, por sikur flegër me shpatë dytehere, prente, rrëzonte, si letër frikacakun, hileqarin, injorantin, çonte lart grushtin mbi ta, i qortonte egër:

Trupin n'Kosovë, kokën pas shpine, s'jeni farë shqiptari, o rod sorrëshkine!

7.

## GJERGJI NË TOKËN E GJERGJIT

(Vargje nga libri im, titullin e të cilit, ma propozoj, Mehmet Kajtazi!)

Gjergj matanë. Gjergj këtanë. Matanë tokë e Gjergjit. Këtanë tokë e Gjergjit. Matanë atdhe i Gjergjit. Këtanë atdhe i Gjergjit. Shkoi Gjergji në tokën e Gjergjit. Erdhi Gjergji në tokën e Gjergjit. Shkoi Gjergji, erdhi Gjergji. Gjergj në Krujë, Gjergj në Prekaz.

- Mirë se erdhe, Gjergj, vëlla!  
- Mirë se të gjeta, vëlla, Adem Jashari!  
- Gjergji me Gjergjin.  
- Gjergji shkoi te Gjergji.  
- Gjergji u kthye te Gjergji.

8. Zogjtë morën fluturimin qiellit bilur mali bëri me dije malet arat bën me dije bujqit bujqit bënë me dije plugët gjyshërit bën me dije lulëkuqet në grurë Baci Li bëri me dije shkabën mbi flamur Nana Zeflie thirri nuse, vasha, vegje motrat, thirren defa, valle, këngë krojet u thanë lumenjve bletët u thanë luleve fëmijët bënë me dije nanat nanat bënë me dije magjet gjithandej Dardanisë





cep me cep Drenisë  
deri në veshë të Vlorës, Krujës  
Prekazi e bëri me dije Shqipërinë  
Shqipëria e bëri me dije Çamërinë  
Çamëria e thirri Hashaninë  
Hashania e thirri Iliridën  
në katër anët e horizontit mbërrti lajmi:  
Sot, në katundin Shpat, me t'vërtetë  
ndodh një mrekulli, nga toka deri në planet  
hapet një Shtëpi e Diellit  
do marrin pjesë, bën me dije mbesa Marenë  
edhe Dradha e Metit, edhe shkrimtari Met!

9.  
Ca minuta para hapjes së Shtëpisë së Diellit  
S'dihej nga erdhi, nga deti a nga bota e planetit  
erdhi një Zë, bash të Dardha e Metit  
foli nana Zelfie, turma sy e veshë :

*"Bijtë e mi, ky za ka dalë nga Bahçjai e Xhenetit  
mirë e njeh nana Zelfie, ky za ashtë zani i Metit!"*

Interesant:

Kur u hap kurora e Dardhës së Shpatit  
Zani fuqishëm jehoi, ishte zani i shkrimtarit:

Me njihni ju, o nuk me njihni, unë nuk e di  
Një gjë dihet sot e mot: Jam fëmijë, jam shkrimtar,  
jam baba i Besimit, i Dritonit, i Migjenit, i  
Mirditës, Linditës ! Jam gjysh, jam mal, jam krua,  
jam lule,  
jam Tërri! Jam Dardha e Metit.  
Jam djalë i Bacit Li!  
Unë u njoh juve, fillepërpe: Ju jeni Shqipëri!

I lus gojë, sytë, shpirtrat, zemrat shqiptare  
i lus këngët, lulet. E lus Dardhën e Metit!

Varrin e Bacit Li! E Lus pushkën e legjendarit...  
Erdha t'u bëj me dije:  
Do hipi në majë të majave të Alpeve shqiptare,  
nga atje do ta thërras: Biblën e dashurisë!  
Do ta thërras e do ta lus që ta përzë nga trojet e  
Dardanisë shpendin kobzi, Qyqe e Qyqes Qyqe!  
Boll kukoi në konaqe, mbi kulme të kullave tona!  
Brejti trojet e Shqipërisë etnike

Shtrija me një dhëmbë!  
Kukoi, vajtoi mbi varre tona! Plisa e lisa!  
Ky shpend sojzi! As ka çerdhe, as djep, as  
s'ka nevojë për të Shqipëria, Dardania, Çamëria,  
për qyqe të qyqeve qyqe. Për lot e vaje!  
Shpenditë e Drenisë çerdhet e veta i kanë.  
Në to çelin e rrisin zogjtë e vet.  
Ata kanë gjuhën, fushë e male, Atdheun e vet!  
The qafën, nga trojet e lashta t Ilirisë,  
o shpend i kobit, i turpit, i ligshisë...

- Të uriturve, bukë!  
- Syve të verbër, dritë!  
- Tokës: shi!  
- Robit, liri!  
- Fëmijëve, lumturi!  
- Kokës, dituri!  
- Atdheut, dashuri!

10.  
Edhe malet u pajtuan!  
Edhe lulet, bletët, pëllumbat u pajtuan!  
Edhe pena e veprat letrare të Metit, u pajtuan!  
Edhe minatorët e Baci Li, u pajtuan!  
Edhe vendlindja e Metit, shpi për shpi, u pajtuan!  
Edhe shkrimtarë nga Shqipëria, Kosova, u pajtan!  
Shtëpia e Diellit, në katundin Shpat, të pagëzohet:  
SHTËPIA PËRKUJTIMORE "TË DARDHA E  
METIT"

Shpërthyen valle, këngë, melodi, urime, zëra:

*"Dielli kurrë s'ka me t'ha, shiu kurre s'ka me t'la".*

11.  
Të pranishmit sytë i bënë katër  
e zemrat i mbushën ëmbëlsi poetike  
me vargjet e poezive të mbesës së Metit  
Marena Kajtazi, poete dhe piktores  
që besa edhe mësimi i shkon shumë përdore  
uruan e përgëzuan vargjet e Marenës, pa hatër  
kushtuar vendlindjes dhe gjyshit Met  
vargje të ëmbla, bashsikur sherbet  
libri i parë me poezi rrafsh një planet  
vargje për flamurin, për gjyshin, ushtarin  
vargje për librin, mësuesen, gjyshen e babanë  
vargje për shkollën, natyrën, Adem Jasharin  
vargje për stinët, për shiun, për zogj e për flutura  
vargje për macen, lejlekun, për ujin, zjarrin  
rrafsh një planet me poezi  
shkroi drenicarja Marena Kajtazi, me duar flori  
10 ekzemplarë ia dhuroi Shtëpisë Përkujtimore  
"Dardha e Metit"

Të gjitha shkronjat, rimat, vargjet poetike  
ia kushtoi gjyshit Met, por edhe gjyshes Salë  
krejt fëmijët e Kosovës janë vargjet e mia  
krejt buzëqeshjet, lumturia, e Kosovës liria  
janë vargje për librin e dytë, pa tjetër  
mollë e dardhë, qersh, shalqi, pjepër...

Faleminderit, babë Besimi, ti nana ime  
që më lindët, më rritët, me diell, lule, dije!

*Drenicë, fillimqershor 2018*



**Punim i A. H. Kajtazi**



Fjalë e mbajtur në konferencën shkencore "40 vjet veprimtari shkencore e krijuese të prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha"

## Kontributi i madh kombëtar e shkencor i prof. dr. Sabile Keçmezi-Bashës në historiografinë shqiptare



Prof. dr. Haki KASUMI

Prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha në vitet e pas luftës çlirimtare në Kosovë bëri një bum të furishëm me botimin e shumë studimeve dhe monografive shkencore me tematikë interesante, aktuale, të qëlluar dhe të pa eksploruar që përfshijnë opusin prej 32 veprave shkencore dhe 16 letrare. Por me këtë rast do të ndalesha dhe të flas vetëm në tri nga këto. Do t'i veçoja monografitë: Sulejman Krasniqi, Veprimtaria atdhetare, Prishtinë, 2012, f. 334; "Veprimtaria atdhetare ilegale në Anamoravë 1945-1968", pjesa e parë, Prishtinë, 2013, f. 409 dhe monografinë "Qëndresa shekullore e familjes Mehaj", Prishtinë, 2015, f. 360. Autorja Sabile Keçmezi-Basha me mendjemprehtësinë, punën dhe përkushtimin e saj intelektual arriti ta përzgjedhë figurën më emblematike të një veprimtari të veçantë të çështjes kombëtare shqiptare të viseve të robëruara nga pushtuesit sllavë të jugut, të shkrimtarit më të përkushtuar të romaneve historike shqiptare, të intelektualit me vull dhe guxim të veçantë të shprehjes së mendimit të hapur kurdoherë dhe para çdokujt, ose si mund të

quhet ndryshe të intelektualit me mendimin e tij kryengritës Sulejman Krasniqi.

Monografia kushtuar kësaj figure emblematike solli porosi bëri hapje të temave tabu të vuajtjeve dhe të persekutimeve të shumë intelektualëve shqiptarë të cilët nuk mund të pajtoheshin me robërinë e vrazhdë të pushtetit okupues jugosllav. Në kushte dhe rrethana të tilla shumë sish u detyruan të largohen nga vendlindja dhe rrethi i tyre familjar dhe ta vazhdojnë jetën në mërgim. Studiuësja prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha është e para që hapi këtë temë të plagës sonë të madhe kombëtare e cila nuk është trajtuar deri në atë kohë nga individ apo nga institucionet tona kërkimore shkencore të vendit. Ajo bëri edhe hapin e dytë të saj në këtë fushë, hulumtoi, studioi dhe shkroi një pjesë të jetës dhe të peripecive të personazhit më karakteristik të përzgjedhurit të saj, shkrimtarit të admiruar Sulejman Krasniqi.

Monografia e dytë, e cilësuar si e veçantë e kësaj studiuëseje të zellshme, konsideroi me të drejtë se është: "Veprimtaria atdhetare ilegale në Anamoravë 1945-1968", pjesa e parë, Prishtinë, 2013, fq. 409.

Prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha deri me tash mban flamurin e hulumtueses dhe studiuëses kampioni i hedhjes dritë në veprimtarinë kombëtare ilegale të shqiptarëve etnikë kundër robërisë jugosllave. Ajo pas shumë kërkimeve shkencore nëpër të gjitha arkivat vendore

dhe regionale, botoi edhe disa monografi me tematikë të lëvizjes patriotike ilegale shqiptare, në mesin e të cilave bënë pjesë edhe monografia "Veprimtaria atdhetare ilegale e Anamoravës 1945-1968", pjesa e parë, me të cilën në mënyrën më të mirë të mundshme u sublimua e vërteta historike e mbështetur në të dhënat e dokumenteve arkivore të kohës dhe të proveniencës së regjimit të pushtetit okupues jugosllav. Autorja e respektuar, prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha, veç të tjerash, arriti të lajë një pjesë të borxhit edhe ndaj babait të saj, të bashkëlufëtarëve të tij si dhe ndaj bashkëvendësve e bashkëkombësve në përgjithësi për sakrificën e tyre në trasimin e rrugës për çlirim të Kosovës.

Dhe monografia e tretë me vlera të veçanta, gjithnjë sipas vlerësimeve të mia personale: "Qëndresa shekullore e familjes Mehaj", Prishtinë, 2015, fq. 360. Duke u nisur nga fakti se ky libër monografik ka për synim të ndriçojë një pjesë të rëndësishëm të rezistencës kombëtare shqiptare në momentet më të vështira nëpër të cilat po kalonte Kosova që nga pas Lufta e Dytë Botërore.

Sakrificat dhe qëndresat e shqiptarëve në përgjithësi dhe të bëmat e familjes shqiptare Mehaj nga Prekazi, të cilat na prezantohen në këtë libër monografik si përjetësi e heroizmit të përsëritur në historinë tonë kombëtare, fenomen ky i përkushtimit atdhetar, do t'u kujtoj gjeneratave të ardhshme se për çlirim dhe

lirinë e këtyre trojeve është dashtë të sakrifkohet shumëçka, mund, djers e gjak, si dhe në fund edhe vetë jeta e shumë shqiptarëve të të gjitha moshave dhe gjinive, që Kosova dhe viset e tjera etnike, një ditë të jenë të lira dhe të bashkuara.

Autorja e nderuar e këtij studimi shkencor, aktual për kohën, intrigues për ngjarjet historike dhe e një rëndësi të veçantë për Kosovën, në veçanti e për shqiptarët në përgjithësi. Ajo, gjithashtu, vë në spikamë se e tërë veprimtaria dhe angazhimi i familjes Mehaj ka karakter kombëtar në tërë të kaluarën e lavdishme historike të disa gjeneratave, në veçanti të Tahir e Nebih Mehës. Kunkludimi i autores se "Lufta e Tahir e Nebih Mehës ishte një ndër levat kryesore që e nxiti dhe e fuqizoi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në Kosovë, në vitet e kthesës së madhe historike të periudhës 1981-1990. Ajo kundërvënie e armatosur - luftë e këtyre dy trimave të Drenicës kundër forcave

policore të perandorisë Jugosllave - jehoi larg dhe sensibilizoi faktorin demokratik ndërkombëtar, zgjoi shqiptarët e përgjumur dhe u tregoi atyre se kishte ardhur momenti i sakrificës së madhe për "liri a vdekje".

Zhvillimet historike nga rënia heroike e Tahir e Nebih Mehës kanë vërtetuar rëndësinë e aktit sublim të sakrificës së tyre. Heroizmi i tyre u kuptua dhe u vlerësua drejt nga individë e familje, madje edhe nga i gjithë populli shqiptar që po dergjej nga robëria e vrazhdë sllave dhe shpejt u shndërrua në një kod kombëtar që të mos lëvizet nga rruga dhe amaneti i Mehajve dhe të gjithë dëshmorëve të kombit se vetëm me sakrificat sublime arrihet liria. Këto janë të veçantat dhe porositë e këtyre tri monografive të koleges së nderuar prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha, të cilën e përshëndes dhe e përgëzoi për punën dhe kontributin e madh në ndriçimin e historisë kombëtare dhe punën e saj voluminoze dhe përmbytjesore.



## Teatrot e qyteteve të Kosovës do të bëhen me ligj të ri

PRISHTINË, 7 GUSHT (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të martën në një takim pune, drejtorët e teatrove të qyteteve kryesore të Kosovës dhe përfaqësuesit e Sindikatës së Teatrot të Kosovës. Në këtë takim ministri Gashi ka diskutuar për situatën e tanishme të teatrove nëpër Kosovë dhe mundësinë e përmirësimit kushteve të tyre të punës dhe stabilitetit financiar të tyre. Ministri Gashi dhe përfaqësuesit e teatrove biseduan edhe për hartimin e projektligjit për teatrot. Gashi i ka njoftuar ata se në këtë fazë MKRS-ja është duke e përgatitur koncept dokumentin i cili do të miratohet në Qeveri duke i hapur rrugë ligjit të ri që, sipas



ministrit, besohet se teatrot e qyteteve të Kosovës do të bëhen me ligj të ri në pjesën e parë të vitit 2019. "Ndër të tjera, ligji do të parashihet rritjen e buxhetit dhe avantazhet e tjera. Po ashtu, kjo politikë e re do t'i obligojë komunat dhe kryetarët e tyre që të ndajnë buxhet shtesë për teatrot dhe rritjen e numrit të stafit dhe futjen e tyre në lista të rregullta të pagave", ka shpjeguar ministri, duke u zotuar se MKRS-ja do të

punojë sa më shpejt që është e mundur për hartimin e ligjit dhe duke përfshirë të gjitha palët e interesit. "Me miratimin e këtij ligji dhe zbatimin e tij, teatrot anekënd Kosovës do të stabilizohen dhe kjo drejtpërsëdrejti do të ndikojë në rritjen e aktiviteteve dhe vlerave artistike", ka vlerësuar ministri Gashi.

Ndërkaq përfaqësuesit e teatrove dhe sindikatës falënderuan ministrin për gatishmërinë e treguar dhe u shprehën se kjo nismë e MKRS-së është e mirëseardhur dhe në përputhje të kërkesave që ata kanë. Ata premtuan se do të angazhohen maksimalisht në bashkëpunim me MKRS-në që ligji në fjalë të jetëshohet sa më shpejt.

## MKRS-ja rrit 100 për qind buxhetin për Qendrën Kinematografike

PRISHTINË, 7 GUSHT - Gjatë vizitës në Qendrën Kinematografike të Kosovës, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka bërë me dije se kjo ministri ka vendosur që ta rrisë 100 për qind buxhetin për qendrën e filmit. Sipas ministrit Gashi, ky vendim ka ardhur si rezultat i punës së madhe dhe sukseseve të arritura ndërkombëtarisht të filmave të Kosovës. "Siç dihet, kjo qendër ka pasur buxhet 600 mijë euro për mbështetjen e filmave dhe ne kemi vendosur që këtë buxhet ta rrisim 100 për



qind dhe QKK-ja do ta ketë buxhetin për filma 1 milion e 200 mijë euro, kurse në total buxheti do të jete 1 milion e 400 mijë euro për shkak të punës së madhe që po ndodh në këtë qendër film", ka thënë Gashi, duke shtuar se me rritjen e buxhetit do të mundësohet financimi i 28 filmave.



E rrallë

## Çiklisti i aksidentuar u shpëtua nga një qen

Martin Ion që pësoi aksident dhe mbeti i lënduar derisa po ngiste biçikletën në malin Semenit të Rumanisë është shpëtuar prej një qeni që i ndenji pranë për ta mbajtur nxehtë. Me të rënë në gropë, ai theu legenin dhe një asht të shpinës, që ia pamundësuan lëvizjen dhe mbeti shtrirë në dhe të ftohtë. "Sikur të mos ishte ky qen, Ion do të pësonte hipotermi dhe nuk do të mbetej gjallë", ka thënë një mjek që i dha ndihmën e parë.



FOTO E DITES



Një migrant shihet duke kërkuar shpëtim në brigjet e Libisë. /AP/

E jashtëzakonshme

## 12-vjeçari do t'i ndjekë studimet në fakultetin e mjekësisë

Carlos Antonio Santamaria nuk është si të gjithë 12-vjeçarët e tjerë. Ai do të nisë së shpejti studimet për fizikë biomjekësore. Ai është studenti më i ri në moshë që është pranuar deri tani në universitetin meksikan, pasi ka kaluar në mënyrë të shkëlqyer testin e pranimit. Sipas mësuesve, Carlos është një nxënës me aftësi të larta njohëse.



## BARSOLETA E DITËS



**Pacienti:** Doktor, jam shumë i shqetësuar. Dëgjoj zëra, po nuk shikoj asnjëri.  
**Doktori:** Kur ndodh kjo?  
**Pacienti:** Kur flas në telefon.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

## “INCREDIBLES 2” 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird



Në ora 18:20

## “FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco



Në ora 20:00

## “ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed



Në ora 22:00

## “LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



**DASHI**

Dashuria është ajo që ju ndjek gjatë gjithë


ditës së sotme, por jeni ju që po tregoheni pak indiferente në këto momente dhe nuk i kushtoni rëndësi.



**DEMI**

Javë e çuditshme që më shumë do të

merreni me udhëtime se me punën tuaj rutinë. Nuk jeni mësuar me këto ritme dhe dita sot do t'ju lodhë.



**BINJAKËT**

Sot do të jeni shumë korrekt me takimet, gjë

që nuk ndodh zakonisht me ju. Në mbrëmje do t'ju pëlqejë surpriza që ka përgatitur partneri.



**GAFORRJA**

Po mudo-heni të vendosni

rregull në një vend që ka pllakosur kaosi. Nuk do t'ia dilni dot mbanë të vetëm, kështu që kërkon ndihmë.



**LUANI**

Duket sikur nuk po ju dëgjojnë

dhe nuk po ju kuptojnë. Mbase është perceptimi juaj i gabuar sepse do të keni rezultate shumë të shpejta.



**VI RGJËR ESHA**

Mendime të kundërta

ju turbullojnë mendjen dhe nuk dini se nga të pozicionoheni. Është mirë ta dëgjoni zemrën ndonjëherë.



**PESHORJA**

Si në jetën në çift ashtu edhe në familje,

këtë periudhë do të dilni si persona që nuk kënaqen kurrë. Ju thjesht doni të jeni të përkryer në hollësi.



**AKREPI**

Intuita sot nuk do t'ju lë në baltë. Në shumë

raste do të kishit gabuar, po sot do të jeni mjaft përpara vetëm falë indicies që keni.



**SHIGJETARI**

Pak interes për të

komunikuar me njerëzit sot dhe dëshirë mjaft e madhe për të qenë më afër me natyrën dhe për aktivitete sportive.



**BRICJAPI**

Sot do ta nisni ditën me këmben e

mbarë dhe po kështu do ta përfundoni. Duhet t'i falënderoni yjet që janë në anën tuaj këtë ditë.



**UJORI**

Megjithëse këtë periudhë jeni të

mbingarkuar, do të gjeni pak kohë për të kaluar në shoqëri të mirë. Miqtë janë ata tek të cilët mbështeteni gjithmonë.



**PESHQIT**

Këtë ditë do të keni logjikë të ftohtë në

marrjen e vendimeve, por do të jeni edhe mjaft të ndjeshëm karshi personave që ju duan.





# Madonna ndryshon jetën 60-vjeçe! Ylli i muzikës rrëfen gjithçka

Portugalia një burim frymëzimi. Këngëtarja e famshme do të transferohet në Lisbonë për të birin futbollist

Nëse do të jetë një jetë e re për yllin e popit kameleonik, që është në zemrat e të gjitha vajzave rebele, do ta shihni me kalimin e kohës. Fakti është se në moshën 60-vjeçare – që i mbush më 16 gusht – Madona ka provuar ndryshime. Jeton prej një viti në Lisbonë së bashku me fëmijët e saj: David Banda dhe Mercy James, 12 vjeç dhe binjakët Stella dhe Esther, 5 vjeç. Ylli i popit, në numrin e revistës Vogue Italia, zbulon arsyet për transferimin dhe tregon për jetën e saj të përditshme në kryeqytetin portugez.

“I thashë vetes: Le të shohim nëse për një vit mund të jetoj diku tjetër dhe t’i çoj katër fëmijët e mi në një mjedis të ndryshëm, sepse mendoj se është e rëndësishme t’i rrisësh fëmijët në kontakt me kultura të ndryshme. Djali im David, i cili më 24 shtator mbush 13

vjeç, dëshiron të bëhet futbollist profesionist. Zgjedhja ishte në mes Akademisë së Juventusit në Torino, Barcelonës dhe Benfikës ose Sportingut në Lisbonë. Shkova atje dhe u përpoqa të imagjinoj se si do të ishte të jetoje në këto qytete. Sigurisht, Barcelona është një qytet fantastik edhe Torino më pëlqen, por nuk më duket e përshtatshme për fëmijët. Është mirë për intelektualët, me të gjitha ato muze të bukura dhe ndërtesa mbresëlënëse, por unë nuk mendoj se fëmijët do të kishin argëtuar. Unë duhet të mendoj për të gjithë, nuk mund të marrë vetëm Davidin në konsideratë. Kështu shkova në Lisbonë dhe në përgjithësi më është dukur zgjedhja më e mirë. Portugalia është e zhytur në histori: perandoria e saj ka lënë shenjë në botë, arkitektura është e jashtëzakonshme. Dhe

duke qenë gjithashtu vendi ku filloi skllavëria, ndikohet nga ndikimet muzikore të vendeve si Angola dhe Cape Verde, si dhe Spanja. Dhe në qoftë se kjo nuk mjafton, një nga aktivitetet e mia të preferuara është të kalëroj. Për të hipur shkoj në Comporta, ose në shtëpinë e një shoku, ose tek Alcácer. Ka shumë zona përreth ku mund të kalërosh dhe çdo herë që djali im nuk ka ndeshje të dielën, atëherë e shfrytëzojmë për të kalëruar”.

Në intervistën me Vogue Italia, Madonna shpjegon se si përvoja e Lisbonës ishte gjithashtu një burim frymëzimi për albumin e saj të ardhshëm. “Unë gjithmonë them se Portugalia qeveriset nga tre f: fado, futboll dhe Fatima. Është gjithashtu një vend shumë katolik, gjë që është shumë mirë për mua. Më kujton Kubën, sepse njerëzit nuk kanë shumë, por hapin derën e çdo shtëpie, shkojnë në ndonjë rrugicë dhe gjithmonë dëgjon muzikë. Gjithmonë dëgjon shumë fado dhe kuduro, një zhanër muzikor

anglez. Gjithashtu edhe shumë xhaz: një gjë e bukur. Kam takuar shumë muzikantë të mrekullueshëm dhe shumë prej tyre përfunduan duke bashkëpunuar në albumin tim të ri, kështu që Lisbona ndikoi në muzikën time dhe në punën time. E si mund të ndodhte ndryshe? E pamundur të kaloja një vit pa qenë e kushtëzuar nga gjithë kultura që më rrethonte”.

Por jeta e nënës së një futbollisti, zbuloi Madona, nuk është fushë me lule. “Çdo grua që u kushton kohë të plotë fëmijëve të saj, që vjen dhe shkon nga fusha e futbollit, do të përgjigjej që në jetë nuk ka pse ndrysho-

jnë gjërat nga javë në javë dhe nga fundjavë në fundjavë: nganjëherë ata janë në qytet, ndonjëherë jo, dhe deri të enjten në mbrëmje nuk e dimë nëse do të jenë të shtunën apo të dielën. Është e pamundur të organizohesh dhe pastaj ke ndjesinë e të qenit e padrejtë ndaj fëmijëve të tjerë, për të mos e llogaritur veten!”

Por, popstarja tregon që të gjithë fëmijët e saj janë përshtatur me ndryshimin. “Gjëja më e habitshme është aftësia e tyre për të kapërcyer çdo pengesë, për t’u zhytur në çdo gjë, në muzikë, vallëzim, në futboll dhe në sport në përgjithësi, aktivitete që i sjellin ata në kon-








marrë vetëm Davidin në konsideratë. Kështu shkova në Lisbonë dhe në përgjithësi më është dukur zgjedhja më e mirë. Portugalia është e zhytur në histori: perandoria e saj ka lënë shenjë në botë, arkitektura është e jashtëzakonshme. Dhe duke qenë gjithashtu vendi ku filloi skllavëria, ndikohet nga ndikimet muzikore të vendeve si Angola dhe Cape Verde, si dhe Spanja. Dhe në qoftë se kjo nuk mjafton, një nga aktivitetet e mia të preferuara është të kalëroj. Për të hipur shkoj në Comporta, ose në shtëpinë e një shoku, ose tek Alcácer. Ka shumë zona përreth ku mund të kalërosh dhe çdo herë që djali im nuk ka ndeshje të dielën, atëherë e shfrytëzojmë për të kalëruar”.

Në intervistën me Vogue Italia, Madonna shpjegon se si përvoja e Lisbonës ishte gjithashtu një burim frymëzimi për albumin e saj të ardhshëm. “Unë gjithmonë them se Portugalia qeveriset nga tre f: fado, futboll dhe Fatima. Është gjithashtu një vend shumë katolik, gjë që



nëse do të jenë të shtunën apo të dielën. Është e pamundur të organizohesh dhe pastaj ke ndjesinë e të qenit e padrejtë ndaj fëmijëve të tjerë, për të mos e llogaritur veten!” Por, popstarja tregon që të gjithë fëmijët e saj janë përsh-

për të kapërcyer çdo pengesë, për t'u zhytur në çdo gjë, në muzikë, vallëzim, në futboll dhe në sport në përgjithësi, aktivitete që i sjellin ata në kontakt të ngushtë me të tjerët dhe lehtësojnë përshtatjen. Djemtë kanë mësuar të flasnin portugalisht, duke qëndruar në mesin e të tjerëve, pa pasur nevojë të kenë një dërrasë të zezë para tyre, për të kuptuar njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë të mësuarit bëhet argëtues, interaktiv. Mbi të gjitha për Stellën dhe Esterën, të cilat kaluan katër vjet në një jetimore; janë kaq të lumtura që janë me të tjerët, që ndihen të dobishme, që janë pjesë e një grupi, i vogël apo i madh qoftë. Ata janë jashtëzakonisht të forta dhe plot me energji dhe gëzim. Janë dy vajza shumë të hapura dhe për shkak të punës sime dhe udhëtimeve të vazhdueshme në mbarë botën, gjërave që bëj dhe vendeve ku shkoj. Të gjithë fëmijët e mi janë shumë të hapur dhe jam shumë krenare

për këtë. Ka njerëz që më thonë: sigurisht doni që djali juaj të bëhet një futbollist i suksesshëm, më i madhi (Lourdes) një balerin, Rocco një piktor. Dhe gjithmonë them jo, ajo që dua për fëmijët e mi është që ata të bëhen njerëz të përgjegjshëm, të aftë për të dashur dhe për të ndier dhembshuri. Asgjë tjetër. Nuk më intereson çfarë rruge ndjekin, vetëm dua që ata të jenë genie të mira njerëzore që t'i trajtojnë të gjithë të tjerët me dinjitet dhe respekt pa marrë parasysh ngjyrën e lëkurës, fenë dhe gjininë. Kjo është gjëja më e rëndësishme. Nëse ata do të bëheshin Picasso tjetër ose Cristiano Ronaldo, shumë mirë, kjo do të ishte qershia mbi tortë”.

Madona gjithashtu foli për Malawi, ku në vitin 2006 ajo themeloi organizatën bamirëse Raising Malawi, e krijuar për të ndihmuar fëmijët vendas jetimë nga AIDS, dhe ku ajo takoi dhe adoptoi fëmijët e saj, David dhe Mercy James. Vitin e kaluar ajo hapi spitalin e parë pediatrik në vend, që mban emrin e vajzës së saj, Mercy James, dhe se ylli i muzikës pop do ta vizitojë së shpejti në përvjetorin e parë të përrurimit. “Ideja nuk është që të sjellim njerëz nga jashtë, por të edukohen dhe të përgatiten malavitët që duan të jenë doktorë, kirurgë, infermierë: kjo është mënyra në të cilën një vend mund të bëhet i vetëm-jaftueshëm dhe krenar në vetvete. Në spital janë kryer ndërhyrje kirurgjikale që nuk bëhen askund tjetër në botë. Javën e kaluar, në kujdesin intensiv, u krye një operacion te dy binjakë siamezë të lindur me mëlcë të përbashkët. Shanset që ata t'i mbijetonin operacionit, – që ata të jetonin, – ishin shumë të pakta. Në fund, jo vetëm që kirurgjia kishte sukses, por fëmijët mbijetuan dhe po shërohen. Dhe sigurisht kjo na bën krenarë dhe do të thotë shumë për njerëzit lokalë dhe komunitetin.

(gazeta-Shqip.com)

Portugalia një burim frymëzimi. Këngëtarja e famshme do të transferohet në Lisbonë për të birin futbollist

Nëse do të jetë një jetë e re për yllin e popit kameleonik, që është në zemrat e të gjitha vajzave rebele, do ta shihni me kalimin e kohës. Fakti është se në moshën 60-vjeçare – që i mbush më 16 gusht – Madona ka provuar ndryshime. Jeton prej një viti në Lisbonë së bashku me fëmijët e saj: David Banda dhe Mercy James, 12 vjeç dhe binjakët Stella dhe Esther, 5 vjeç. Ylli i popit, në numrin e revistës Vogue Italia, zbulon arsyet për transferimin dhe tregon për jetën e saj të përditshme në kryeqytetin portugez.

“I thashë vetes: Le të shohim nëse për një vit mund të jetoj diku tjetër dhe t'i çoj katër fëmijët e mi në një mjedis të ndryshëm, sepse mendoj se është e rëndësishme t'i rrisësh fëmijët në kontakt me kultura të ndryshme. Djali im David, i cili më 24 shtator mbush 13 vjeç, dëshiron të bëhet futbollist profesionist. Zgjedhja ishte në mes Akademisë së Juventusit në Torino, Barcelonës dhe Benfikës ose Sportingut në Lisbonë. Shkova atje dhe u përpoqa të imagjinoj se si do të ishte të jetoje në këto qytete. Sigurisht, Barcelona është një qytet fantastik edhe Torino më pëlqen, por nuk më duket e përshtatshme për fëmijët. Është mirë për intelektualët, me të gjitha ato muze të bukura dhe ndërtesa mbresëlënëse, por unë nuk mendoj se fëmijët do të kishin argëtuar. Unë duhet të mendoj për të gjithë, nuk mund të



është shumë mirë për mua. Më kujton Kubën, sepse njerëzit nuk kanë shumë, por hapin derën e çdo shtëpie, shkojnë në ndonjë rrugicë dhe gjithmonë dëgjon muzikë. Gjithmonë dëgjon shumë fado dhe kuduro, një zhanër muzikor anglez. Gjithashtu edhe shumë xhaz: një gjë e bukur. Kam takuar shumë muzikantë të mrekullueshëm dhe shumë prej tyre përfunduan duke bashkëpunuar në albumin tim të ri, kështu që Lisbona ndikoi në muzikën time dhe në punën time. E si mund të ndodhte ndryshe? E pamundur të kaloja një vit pa qenë e kushtëzuar nga gjithë kultura që më rrethonte”.

Por jeta e nënës së një futbollisti, zbuloi Madona, nuk është fushë me lule. “Çdo grua që u kushton kohë të plotë fëmijëve të saj, që vjen dhe shkon nga fusha e futbollit, do të përgjigjej që në jetë nuk ka pse ndryshojnë gjërat nga javë në javë dhe nga fundjavë në fundjavë: nganjëherë ata janë në qytet, ndonjëherë jo, dhe deri të enjten në mbrëmje nuk e dimë

tatur me ndryshimin. “Gjëja më e habitshme është aftësia e tyre





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

**Sport**

**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

CELTIC - AEK ATHENS

3+

COTTBUS - UNTERHACHING

1

GOLDEN ARROWS - BLOEMFONTEIN

1

# Behrami: Vendim politik, i zhgënjyer që ma thanë me një telefonatë

**CYRË, 7 GUSHT** - Pas lajmit të publikuar ditën e hënë, se trajneri Petkoviç po bënte një revolucion tek kombëtarja e Zvicrës, ku mes disa të përjashtuarve ishte edhe Valon Behrami, është vetë 33-vjeçari që, në një intervistë për "RSI", ka treguar çfarë ka ndodhur.

**Valon Behrami, juve ju ka telefonuar Vladimir Petkoviç të hënë pasdite. Çfarë ju ka thënë?**

**Behrami:** Dua të them, mendova se ishte një telefonatë korteze, por në atë telefonatë ai dëshironte të më tregonte derën e Kombëtares. Një muaj pas humbjes në Kupën e Botës në Rusi kishte dinamika të cilat nuk më pëlqenin.

**Çfarë dinamikash?**

**Behrami:** Dinamika të cilat nuk i përshtateshin qëllimit tim në skuadër. Unë gjithmonë e kam promovuar unitetin. Skuadra duhet të jetë gjithmonë e bashkuar, si në situata pozitive, ashtu edhe në situata negative. Te ne kishte një ndarje, por si djalë i ri unë tentova të ndërtoj një skuadër, kështu jam rritur unë. Sporti, mbi të gjitha futbollit, i bashkonjë kombësitë dhe kulturat e reja. Rezultati është një kombëtare e bashkuar dhe kjo është ajo që e karakterizonte Zvicrën. Gjithmonë kam luftuar për këtë gjë.

**Çfarë do të thuash me ndarje? A është fjala për festimin me shqiponjë të Xhakës dhe Shaqirit dhe reagimet që ka shkaktuar kjo?**

**Behrami:** Pajtohem. Ai gjest na ndau neve, tregoi një anë tjetër tonën. Ne jemi duke shkuar në një drejtim dhe duam të krijojmë një ambient të mirë rreth nesh, gjë që e bën krenar Zvicrën. Pastaj u larguam nga Kupa e Botës. Në këtë pikë, është e lehtë të kritikosh, të gesh një ndarje mes nesh. Neve na thanë se e preferojmë një komb më shumë se tjetrin, por ne e kemi dëshmuar se ne i përkasim vetëm një kombësie. Ne gjithmonë e kemi përgjegjësinë si zvicëran si në



fitore ashtu edhe në humbje.

**Ata gjithmonë tentonin të krijojnë unitet brenda skuadrës. Tani ndiheni sikur të kanë vendosur para derës.**

**Behrami:** Gjithmonë kisha menduar se do të largohesha më herët. Por, këtë vit ndihesha sikur isha integruar plotësisht brenda skuadrës dhe ndihesha si lider. Dhe tani më kanë lënë para derës. Trajneri mund të thotë çfarë të dojë. Është një vendim politik. Unë gjithmonë e kam mbrojtur veten kundër njerëzve që nuk e kuptojnë se çfarë është futbollit. Ju nuk keni luajtur asnjëherë futboll. Ky është problem i madh me shoqatat e Zvicrës. Ata gjithmonë tentojnë t'i ruajnë pozitën e tyre, por nuk e kanë asnjë ide se si ndihen lojtarët. Njerëzit thonë se ne kurrë nuk u munduam. Kjo më lëndon. Por e di, kështu është. Në të njëjtën kohë, e gjitha kjo nuk është problem shumë i madh për mua. Tani kam më shumë kohë për vajzat dhe gruan time. Isha i pasigurt gjatë vendimmarrjes, kështu që nuk është në pyetje egoizmi. Unë jam 33-vjeçar, me siguri do të pensionohesha kur të jem 35-vjeçar. Nuk ka asnjë problem. Gjithmonë kam provuar të japë më të mirën

time, ju e keni parë këtë gjë. Në fillim ishte e vështirë, por pastaj reagova fuqishëm. Dua ta përsëris edhe një herë: unë gjithmonë kam marrë përgjegjësi. Edhe sot, po ashtu. Qëndroj faqebardhë dhe them se është gabim të më tregoni në këtë mënyrë se nuk jam më pjesë e projektit tuaj. Dua të ma thonë këtë vendim ballë përballë. Kjo gjë nuk ndodhi. Të gjithë e panë se çfarë ndodhi pas ndeshjes kundër Suedisë. Dhe tani duket se

kjo ka çuar deri te ky vendim. Por, unë kam thënë: Qëndroj këtu, nuk dua t'u ndodhin gjëra të këqija. Unë mund të largohem, udhëtimi im është afër përfundimit. Njerëzit të cilët u prekën nga kjo gjë më telefonuan për të kërkuar ndihmë. Unë u dola në ndihmë.

**Cilët njerëz? A mund ta thoni një emër?**

**Behrami:** Sekretari i përgjithshëm.

**Atëherë Miescher. Ai i ka kritikuar lojtarët e kombëtares me dy kombësi. Edhe pse ju nuk i keni dy pasaporta. Për shembull, a nuk donin më Xhaka dhe Shaqiri të luanin për Kombëtaren e Zvicrës?**

**Behrami:** Jo saktësisht ata të dy, por ka lojtarë që reagojnë në mënyrë të dhunshme. Unë gjithmonë kam tentuar t'i qetësoj. Pastaj sekretari i përgjithshëm më telefonoi dhe më kërkoi ndihmë për t'i qetësuar kolegët. Unë e bëra këtë gjë pasi gjithmonë kam dashur të kem një skuadër të bashkuar, e jo të ndarë. Ai thotë se më ka shkruar një mesazh specifik. Kjo gjë nuk ka ndodhur kurrë. Gjithçka ndryshoi dhe tani ndodhemi në këtë situatë.

**A ndiheni më shumë i zhgënjyer apo i zemëruar?**

**Behrami:** Unë jam i zhgënjyer. Gjithashtu, jam njeri, kam ndjenja për njerëzit këtu. Po flas për trajnerin dhe të gjithë grupin. Si person, kjo po më lëndon shumë. E di se zhgënjime të tilla janë pjesë e karrierës së një futbollisti, e di se këto ndodhin shpejt. Por, unë mendoja se mund t'u besoja disa njerëzve të caktuar sa i përket fatit tim, të paktën. Të ma thonë atë në fytyrë. Ta vendosin dorën e tyre mbi shpatullat e mia. Dhe jo të ma thonë në një telefonatë 30-sekondëshe se unë më nuk jam pjesë e projektit të tyre.

**A do ta mbështesësh Kombëtaren e Zvicrës në të ardhmen?**

**Behrami:** Normalisht! Unë e mbështes Zvicrën, një skuadër që duhet të jetë e bashkuar. Unë e telefonova Xhakën menjëherë dhe i thashë: shpresoj se ti do të jesh lideri i vërtetë në këtë skuadër dhe shpresoj se të kam ndihmuar gjatë kohës sime aty. Ai më tha se gjithmonë kisha qenë një shembull i mirë për të. Këto janë gjëra që nuk harrohen asnjëherë. Gjithmonë do ta mbështes Zvicrën.

## Mbështetje e madhe për Valon Behramin

Përrashtimi i Valon Behramit është lajmi i ditës në medien zvicëranë, e cila në përgjithësi ka rezultuar kritike në drejtim të Federatës Zvicëranë dhe trajnerit Petkoviç për mënyrën se si administruan situatën me Behramin. "Federata Zvicëranë e humbi kontrollin", thekson Noje Zyrher Xaitung. "Ajo dhe trajneri treguan mungesë respekti ndaj një futbollisti që ka dhënë shumë për skuadrën". "Re të zeza kanë rënë mbi kombëtaren", shkruante "Argauer Xaitung". Ndërsa "Tages Anxaiger" shkruan se largimi i Behramit nga kombëtarja është

vetëm zhurma e fundit e ngritur rreth skuadrës. Situata do të mbetet e ndërë pasi çështja e lojtarëve me dy pasaporta është ende shumë e hapur. Ndërsa "Tagblat" publikon një letër të hapur drejtuar Valon Behramit ku e falënderon për kontributin e madh që ai ka dhënë, ndërkohe që shfaq edhe befasinë për mënyrën se si e menaxhoi këtë situatë Federata Zvicëranë e Futbollit për ta mbyllur letrën me frazën: Do ta ndiejmë mungesën tënde. Një mesazh lamtumire nga kombëtarja zvicëranë, Valon Behrami mori edhe nga Granit Xhaka. "Valon,

ajo që mund të them është shumë faleminderit. Je një ikonë e vërtetë e kombëtares zvicëranë. Krijam kujtime në fushë, u bëmë miq përjetë", shkruante Granit Xhaka në "Instagram". Mesazhe të shumta Valon Behrami ka marrë edhe nga tifozë të shumta zvicëranë, një pjesë e mirë e të cilëve nuk i kursyen kritikën ndaj Petkoviçit, siç është rasti i përdoruesit së "Twitter"-it, Miss Fairysdust, e cila shkruante: "Ky ishte një gabim i madh Petkoviç. Valon, do ta ndiejmë shumë mungesën tënde. Faleminderit për atë çfarë bërë për vendin tonë!"

## Veteli ende beson në përmbysje: Ferrari ka ende potencial për të dhënë



**BERLIN, 7 GUSHT** - Sebastian Veteli ka lënë pas krahëve zhgënjimin e dy garave të fundit, ku nuk arriti të fitojë dhe tashmë diferenca e tij me Hamiltonin, që kryeson renditjen e Formula 1, është 24 pikë. Pavarësisht prej kësaj, piloti gjerman i Ferrarit beson se asgjë nuk

është e përfunduar dhe se pjesa e dytë e sezonit mund të ndryshojë sërish fatin e Botërorit. "Këtë vit kemi treguar se makina jonë është më efikase dhe më e fortë se ajo e rivalëve. Megjithatë, unë jam i bindur se Ferrari ka ende potencial për të treguar", ka thënë Veteli. Për

pasojë, katër herë kampioni i botës është i bindur se gjërat do të ndryshojnë pas pushimeve verore. "Ndryshe nga vjet, kur humbëm garën me Mercedesin, pasi nuk u përmirësua në pjesën e dytë të kampionatit, këtë sezon gjërat janë ndryshe. Makina është e shpejtë

dhe kjo është e rëndësishme. Këtë herë mund t'i vëmë nën presion rivalët dhe të marrim një rezultat më të mirë. Duhet të punojmë fort për të treguar në pistë se kush jemi, duke marrë maksimumin nga kjo makinë", ka deklaruar Veteli.



## Mourinho nuk lejon largimin e Pogbas nga Unitedi

MANCHESTER, 7 GUSHT - Paul Pogba ka qenë lojtari që ka trazuar afatin kalimtar gjatë këtyre ditëve, por nuk do të ketë asnjë "bum". Manchester Unitedi ka vendosur "veton"

dhe mesfushori francez do të mbetet pjesë e këtij klubi. Barcelona e donte mesfushorin, por nuk ka arritur dot të bëjë ofertë për kartonin e tij. Trajneri Jose Mourinho ka

refuzuar çdo mundësi për shitjen e kampionit të botës, ndërkohë që klubi menjëherë ka ngritur "murin" dhe e ka cilësuar të pashitshëm mesfushorin. Edhe pse Mino Raiola

u përpoq të bënte diçka, duke shkuar vetë drejt e në Manchesterit, "Djajtë e Kuq" nuk janë bindur të futen në tratativa. Në këtë mënyrë Pogba do të mbetet pjesë e Unitedit.



# Fetahaj: E ardhmja ime vendoset brenda javës

Liridon Fetahaj është mes qëndrimit dhe largimit nga Prishtina. Disa klube e kanë kontaktuar, por kontrata me kryeqytetasit ka ndikuar që ai të mos mund të vendosë për të ardhmen. "Kontrata ime me skuadrën e Prishtinës është dy vjet të tjera. Ende nuk kemi vendosur asgjë me klubin, por brenda javës do të dihet përfundimisht se do të mbetem pjesë e Prishtinës apo të largohem", ka thënë Liridon Fetahaj

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 GUSHT - Te skuadra e Prishtinës janë bërë disa ndryshime në këtë afat kalimtar, por e ardhmja e Liridon Fetahajt ende nuk është sqaruar përfundimisht. Futbollisti që iu bashkua Prishtinës me shumë bujë vitin e kaluar nuk ka mundur të sigurojë shumë minuta në formacionin e trajnerit shqiptar, Mirel Josa dhe për këtë arsye gjithçka mbetet e hapur rreth të ardhmes së tij. Gazeta e ka kontaktuar të martën Fetahajn, i cili ka bërë me dije se ka kontratë edhe dy vjet me Prishtinën, kurse për të ardhmen i ka lënë të gjitha opsionet e hapura. "Kontrata ime me skuadrën e Prishtinës është dy vjet të tjera. Ende nuk kemi vendosur asgjë me klubin, por brenda javës do të dihet përfundimisht se do të mbetem pjesë e Prishtinës apo të largohem", ka thënë Fetahaj. Ish-lojtari i Lirisë së Prizrenit ka marrë disa oferta në këtë afat kalimtar, ani pse është nën kontratë me skuadrën kryeqytetase. Ai konfirmoi se dëshira e tij është



vetëm të ketë minuta më shumë, duke lënë të nënkuptohet se është gati të largohet nga Prishtina. "Oferta kam marr mjaft shumë, por kjo është një gjë tjetër sepse jam një lojtar i Prishtinës. Dëshira ime është të luaj dhe nëse kjo gjë nuk është e mundur te Prishtina, atëherë pse jo edhe të largohem", ka shtuar ai. Ashtu sikurse Fetahaj, edhe Mentor Mazrekaj është lojtar i Prishtinës, por e ardhmja e tij nuk dihet. Ditë më parë nga kjo

skuadër është larguar sulmuesi Ahmet Jonuzi, i cili nuk gjeti gjuhë të përbashkët për vazhdimin e kontratës, derisa Debatik Curri e ka përfunduar karrierën dhe do të jetë pjesë e stafit teknik. Prishtina që mori pjesë në garat e Evropa Ligës deri tash ka transferuar Mertin Korenicën (Liria), Ahmet Halitin (Feronikel), Argjend Mustafën (Trepça '89) dhe dyshen e Gjilanit, Armend Thaçi e Leotrim Bekteshi.

# Kosova: Kosova gati për evropianin e hendbollit

PRISHTINË, 7 GUSHT - Trajneri i Kombëtares U18 të Kosovës në hendboll, Fadil Kqiku, është i kënaqur me punën që bën Kombëtarja U-18, e cila sonte (e mërkurë) merr rrugë për në Austri, ku do të paraqitet në Kampionatin Evropian, Divizioni B. U18 ka luajtur dy ndeshje stërvitore ndaj Malit të Zi. Në ndeshjen e parë pësoi humbje me rezultat 32:29, kurse në të dytën dallimi në rezultat ishte më i madh 30:18. "Ne patëm dy lojë miqësore që ishin të mirëseardhura për ne si shtab teknik dhe, po ashtu, për lojtarët. Provuam disa gjëra në mbrojtje dhe sulm. Ishin



dy rezultate të kundërta, që edhe është pritur shkak i lodhjes dhe përgatitjes fizike. Jam i kënaqur me të dy ndeshjet, pasi provuam

gjëra të reja dhe fituan rastin të gjithë 18 lojtarët që i kemi në grumbullim", ka thënë trajneri Kqiku. Kosova në Austri do të ketë përballë kombëtare të forta evropiane dhe trajneri Kqiku është i vetëdijshëm që pritjet nuk janë të mëdha nga gjenerata që është në konsolidim e sipër. U18 më 10 gusht luan ndaj Holandës, kurse më 11 gusht takohet me Sllovakinë e më pas me Letoninë, Austrinë e Bullgarinë, para se t'i zhvillojë ndeshjet për plasman. "Do të punojmë dhe të mendojmë që në evropian të paraqitemi sa më mirë", ka deklaruar Kqiku.

## SHKURT

### Mavraj, afër Olympiacosit

Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Mërgim Mavraj, pas ndarjes me Hamburgun vazhdon të jetë lojtar i lirë. Pas interesimit nga Turqia dhe Italia, Mavrajn e kërkuan edhe Hannover 96 dhe AEK-u. Kjo e fundit hoqi dorë nga Mavraj, pasi kërkesat e futbollistit janë të larta dhe të papërbalueshme për këtë klub. Tash garës për transferimin e tij i ka hyrë skuadra tjetër greke, Olympiacos. Brenda pak ditësh, sipas medieve në Greqi, do të dihet e ardhmja përfundimtare e mbrojtësit nga Istogu.

### Buffon: Mbappe si Pele, Maradona, Messi dhe CR7

Gianluigi Buffon në këtë afat kalimtar u largua nga Juventusit dhe iu bashkua Paris Saint-Germainit. Portieri italian e vlerësoi yllin e PSG-së, Kylian Mbappe, me Pelen, Maradonan, Messin dhe Ronaldon. "Ka diçka speciale, është ndryshe nga të tjerët. Nëse qëndron i thjeshtë dhe ka dëshirë të punojë e sakrifikojë, do të shkojë larg. Është si Pele, Maradona apo si Messi e Ronaldo", ka thënë Mbappe.

### Monroe transferohet te Toronto

Greg Monroe do të ndryshojë sërish skuadër në NBA. Lojtari shtatlartë ka arritur një marrëveshje me Toronto Raptorsin. Ai u zgjodh si zgjedhja e shtatë në draftin e vitit 2010 dhe ka kaluar pesë vjetet e para në karrierë me Detroit Pistonsin. Në 2015-n ai nënshkroi një kontratë trevjeçare, ku përfitoi 50 milionë dollarë me Milwaukee Bucks. Në sezonin që lamë pas, Monroe luajti me tri skuadra. Fillimisht me Bucksin, më pas u shkëmbye me Eric Bledsoe e shkoi tek Phoenix Suns dhe në shkurt nënshkroi me Boston Celticsin. Gjatë kampionatit të shkuar ai shënoi një mesatare prej 10.3 pikësh e 6.9 topash në tabelë për ndeshje. Në dy vjetet e fundit ka pasur një rënie të performancës së tij, por gjithsesi ai mund t'i sjellë shumë ekipit të tij të ri, edhe për shkak të përvojave të tij. Me Serge Ibaka dhe Jonas Valanciunas, që e kanë provuar tashmë veten për ekipin kanadez, Monroe me shumë gjasa do t'i nisë ndeshjet nga stoli, por pritet të ketë një minutazh të lartë dhe të jetë një lojtar kyç për trajnerin e ri të Raptorsit, Nick Nurse.

### Kroosi: Vështirë ta zëvendësosh Ronaldon

Mesfushori Toni Kroos ka thënë se Real Madridi do ta ketë shumë të vështirë ta zëvendësojë Cristiano Ronaldon. "Kur humbësh një lojtar që shënon 50 gola në sezon, është e dhimbshme dhe e vështirë për ta zëvendësuar. Cristiano ka qenë shumë i rëndësishëm për ne ndër vite dhe ka qenë lojtari kyç në sukseset tona. Nuk kam asnjë dyshim se të tjerët do ta kenë përsëri shumë të vështirë të fitojnë kundër nesh", ka thënë Kroos.

### Neuer: Duam ta fitojmë Superkupën

Kapiteni i Bayern Munchen, Manuel Neuer, kërkon fitore në finalen e Superkupës ndaj Eintracht Frankfurt. "Superkupa është një trofe që nuk duhet nënvlerësuar. Kërkojmë ta fitojmë sezonin në rrugën e duhur. Jemi kampionë të Bundesligës dhe si të tillë duhet të sillemi edhe në fushën e lojës. Trajneri po punon shumë mirë dhe ka kërkuar nga ne të jemi të fokusuar gjatë kohës kur stërvitemi", ka thënë Neueri.

### Harti transferohet te Burnley

Portieri Joe Hart edhe zyrtarisht është larguar nga Manchester City. Pas dy vjetëve të kaluara në huazim, fillimisht te Torino e më pas te West Hami, Joe Hart largohet përfundimisht nga City, pasi ka nënshkruar me skuadrën e Burnleyt. Për 31-vjeçarin, Burnley ka paguar rreth katër milionë euro, derisa Hart ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me këtë klub. Ish-reprezentuesi anglez ka qenë pjesë e Cityt për 12 vjet, po ardhja e Pep Guardiolas ka bërë që ai të largohet nga kampionët e Anglisë. Me "Citizens", Hart ka fituar dy herë Premier Ligën.



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ▶ N.T.Sh "FAB" shpall të pavlefshme certifikaten e TVSH-së me numër: 330270231
- ▶ Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perlleshi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151
- ▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- ▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- ▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtinë, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

**Shijo Pranverën me...**

**Jaffa Champion PLUS**  
**A+C+E Multifrutti**

Taste of World Wide Brand!

2L

**Jaffa Champion**





REPUBLICA E KOSOVËS

 REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
 Komuna e Dragashit - Opština Dragas  
 Drejtorati për Arsimit dhe Kulturë  
 Direktorijati za Prosvetu i Kultura

Nr. Br. 13/522

06-08 20 18

SHML "RUZHDI BERISHA" DRAGASH

E-mail: profi-history@hotmail.com tel.029281548 Tel. 044 112-900

 Nr.pr. 990  
 Dragash me: 06.08.2018

Për: DKA

Drejtoria e SHML "Ruzhdi Berisha" në Dragash, në bazë të UA.02/2016 neni 11 pika 1 dhe 2 fton:

**FTESË PËR OFERTË**

Ftojme të gjitha kompanitë e autobusëve të interesuara të paraqesin ofertat e tyre për ekskursion të nxënësve maturant.

**KUSHTET E OFERTIMIT;**

1. Agjencioni i licencuar
2. Kontrolla teknike e kryer në bazë të procedurave ligjore
3. Të ketë numer të caktuar të autobusëve për nevoja të shkollës
4. Autobuset komfort dhe me klimatizim
5. Agjencioni të mos ketë referenca negative
6. Drejtuesit e autobusëve të posedojnë dokumentacionin e nevojshëm
7. Agjencioni është i obliguar të siguroj përkujdesje shendetësore për nxënës dhe personel të shkollës
8. Agjencioni duhet të siguroj vendosjen dhe ushqimim për nxënës dhe personel
9. Të kalkulohet çmimi për kokë të nxënësit

Shkolla i ka 8(Tetë ) paralele ku përafërsisht janë 180 nxënës. Numri i saktë i nxënësve të cilët shkojnë në ekskursion do të dihet ditën e hapjes së ofertave . Ekskursioni do të organizohet jashtë Republikës së Kosovës konkretisht në Republikën e Shqipërisë, qëllimi është vizita e disa prej qyteteve të Shqipërisë si dhe vizita e disa monumenteve historike në Shqipëri. Ekskursioni është 5 ditor.

Ofertat dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit në emer të shkollës që ka bërë ftesën për ofertë.

Afati i dorëzimit të ofertave bëhet prej datës 09.08.2018 deri me 17.08.2018 në ore 13.30 kur do të bëhet edhe hapja e ofertave në DKA në Dragash.


 Drejtori:  
 Shukri Nebija



 Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta -Ministry of Culture, Youth &amp; Sports

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSIEME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

07.08.2017

**NJOFTIM PËR ZGJATJEN E PRANIMIT TË APLIKACIONEVE**

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbështetur në Procedurat e Rekrutimit, njofton se për të arritur pranimin e balancuar të aplikacioneve nga aspekti gjinor dhe etnik zgjat edhe për 7 ditë kalendrike pranimin e aplikacioneve për pozitën;

Kostumograf në Teatrin Kombëtar të Kosovës

**OBAVEŠTENJE O PRODUŽENJU PRIMANJA APLIKACIJA**

Ministarstvo Kulture Omladine i Sporta oslanjajući se o proceduri primanja, obaveštava vas da u cilju dostizanja za balansni prijem aplikacija sa polnog i etničkog aspekta, nastavlja se za još 7 kalendarskih dana primanje aplikacija za sledeće poziciju;

Kostumograf Nacionalno Pozorište Kosova

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se "Ewan the dream sheep MAKS", SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810085870 dhe nr.fiskal: 810085870 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Ewan the dream sheep MAKS" D.O.O. od Pristina, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 810085870 i broj fiskala: 810085870 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the "Ewan the dream sheep MAKS", L.L.C. in Prishtina, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 810085870, i number fiskal: 810085870 The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Shtojca 5: Njoftimi për shprehje të interesit****Njoftimi për shprehje të interesit**

Emri i shkollës: OINSŠ "Zenuni" Brod

Komuna: Dragash

Data:08.08. 2018

Emri i kontratës:Mbulimi i shkolles me rrjetin e internetit

Numri i kontratës: ESIP/SDG/007-CS/1.2

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles OINSŠ „Zenuni“ Dragas. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshme:

 1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:  
 Mbulimi i shkolles me rrjetin e internetit

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën Adresa e Shkolles OINSŠ „Zenuni“ , Dragas më së largu deri më 16.08. 2018.

4. Termat e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'i dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet lutën që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Kontakt osoba: Cenani Skenderoski

Broj telefona: 044/494-155

e-majl: cenanbrod@hotmail.com





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## AUTOSHKOLLA “RITMO – L”

**Auto Shkolla  
“RITMO - L”  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:**

**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**